

1 E premte, 29 tetor 2021

2 [Konferencë për ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 14.31

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përshëndetje, të gjithëve
7 në sallën e gjyqit dhe jashtë saj. Mendoj që nuk e kam parë
8 asnjëherë sallën e gjyqit me kaq shumë njerëz. Besoj se kjo që
9 është shenjë e mirë që tregon që pandemia më në fund po
10 përfundon.

11 Zonja Sekretare, a mund të thërrisni çështjen, ju lutem.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar,
13 kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar
14 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
15 Krasniqit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
17 Sekretare.

18 Tani do t'i kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
19 prezantohen, duke filluar me Zyrën e Prokurorit të
20 Specializuar.

21 Zonja Prokurore, fjala për ju.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Përshëndetje, i nderuar Gjykatës.
23 Përshëndetje të gjithëve.

24 Për Prokurorin e Specializuar i pranishëm sot është Alan
25 Tieger, Prokuror i Lartë; z. Ferdinanduesse, Drejtues i

1 Prokurorisë lidhur me hetimet; Marlene Yahya Haage, Oficere e
2 Nxjerrjes së Materialeve; dhe unë jam Clare Lawson, Prokurore
3 e Lartë. Kemi dhe Nathan Quick, Drejtues i Skuadrës së
4 Asociuar [sipas përkthimit].

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i drejtohem
6 Mbrojtjeve. Duhet të filloj me z. Kehoe.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Përshëndetje, faleminderit. Kënaqësi
8 që shihemi sërish. Unë jam z. Kehoe në emër të z. Thaçi. Kam
9 së bashku Dastid Pallaskën, kemi gjithashtu dhe Sophi Menegon
10 dhe Bonnie Johnaston. John Greenblantt është po ashtu me neve.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani z. Emmerson, fjala për
12 ju.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Mikrofoni i paktivizuar].

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, mikrofonin ju
15 lutem.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndjesë. Përshëndetje.
17 Përshëndetje, i nderuar Gjykatës. Përshëndetje të gjithëve ju
18 që jeni të pranishëm në sallën e gjyqit dhe ju që e ndiqni në
19 distancë. Unë jam Ben Emmerson, jam Mbrojtësi i Kadri Veselit.
20 Sot ndihmohem në sallë nga Pascale Langlais, që është
21 Ndhmësja Ligjore; Annie O'Reilly dhe në distancë nga Andrew
22 Strong, që është bashkëmbrojtja.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani z. Roberts, fjala për
24 ju.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam Geoffrey

1 Roberts në emër të z. Selimi, jam së bashku me znj. Natasha
2 Ryzhenko, Menaxherja e Çështjes.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani znj. Alagendra.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Përshëndetje, zoti Gjykatës. Unë
5 jam përfaqësuesi i z. Krasniqi. Mbështetem në Gjykatë nga
6 Victor Baiesu; ndërkohë pas meje është Kalina Tzvetkova, që
7 është Menaxhere e Çështjes dhe në videolidhje sot kemi të
8 pranishëm gjithashtu Drejtuesen e Mbrojtjes së z. Krasniqi,
9 znj. Alagendra, gjithashtu edhe Mentor Beqirin.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le t'i japim fjalën
11 Avokatit për Viktimat. Megjithatë përpara se sa të vijojmë me
12 të, do të doja të thosha, që të akuzuarit nuk janë të
13 pranishëm këtu në sallë por e ndjekin seancën përmes
14 videolidhjes.

15 Z. Laws?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam Simon Laws,
17 jam Avokati i caktuar kryesisht për Viktimat.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani më lejoni t'ia jap
19 fjalën Zyrës së Administratës.

20 Z. ROCHE: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam Ralph Roche.
21 Unë përfaqësoj Shërbimet Gjyqësore në Gjykatë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roche.

23 Për procesverbal, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatësi i
24 kësaj çështjeje.

25 Më 18 tetor 2021 unë planifikova këtë konferencë të tetë

1 për ecurinë e çështjes. Dhe i kërkova palëve që të jepnin
2 parashtrimet e tyre me shkrim.

3 Më 27 tetor 2021, ZPS-ja dhe Mbrojtja për z. Selimi dhe
4 z. Krasniqi parashtruan konstatimet e tyre me shkrim. I
5 falënderoj palët për parashtrimet me shkrim.

6 Qëllimi i seancës së ditës së sotme është që të
7 shqyrtojmë gjendjen e çështjes dhe të diskutojmë temat në
8 agjendë; specifikisht, të diskutojmë për nxjerrjen e
9 materialeve, përkthimet, hetimet e ZPS-së dhe hetimet e
10 Mbrojtjes. Do të ftoj palët që të përfaqësojnë pikëpamjet e
11 tyre në mënyrë koncize lidhur me secilën prej këtyre zërave.
12 Si zakonisht, i kujtoj palëve që të na njoftojmë në qoftë se
13 ndonjëri prej parashtrimeve të tyre do të kërkojë nxjerrjen e
14 informacionit konfidencial në mënyrë të tillë që të shkojmë në
15 sesion privat ose të mbyllur.

16 Më lejoni që atë fillojmë me temën e parë që është
17 listuar në urdhrin për planifikimin e kësaj seance, që është
18 nxjerrja e materialeve.

19 Siç kam bërë edhe në konferencat e tjera, do t'i jap
20 fjalën secilës prej palëve që të japin parashtrimet e tyre
21 lidhur me secilën prej kategorive të materialit provues
22 veçmas, do të fillojmë me materialit sipas rregullit
23 102(1)(b), që është material provues që ZPS-ja synon që të
24 përdorë në gjykim; materiali 102(3), që është materiali që
25 është i rëndësishëm për çështje siç listohet nga ZPS-ja;

1 materiale sipas rregullit 103 që është materiali shfajësues;
2 dhe, së fundmi, materiali sipas rregullit 107 që është
3 material i mbrojtur për të cilin kërkohet pëlqimi i ofruesit
4 të këtij informacioni.

5 Informoj palët që për diskutimet mbi materialin sipas
6 rregullit 102(1)(b), së pari, do t'i jap atyre fjalën për të
7 diskutuar për afatet kohore për nxjerrjen e materialit. Dhe në
8 një raund të dytë do të diskutojmë kërkesën e Mbrojtjes së z.
9 Selimi për lidhje të mëtejshme të materialit provues. Pra, kjo
10 do të bëhet në një raund të veçantë diskutimi.

11 Le të fillojmë diskutimin mbi bazën e materialit për
12 rregullin 102(2)(b), në veçanti për afatet kohore.

13 Në konferencën e fundit për gjendjen gjyqësore të
14 çështjes, unë lëshova një urdhër gojor lidhur me afatin gojor
15 të ZPS-së lidhur me materialin sipas rregullit 102(1)(b). E
16 zgjata afatin deri më 1 nëntor 2021 për deklaratat e tri
17 dëshmitarëve ndërkombëtarë të cilët duhet të japin pëlqimin e
18 tyre sipas rregullit 107, raportet e tri dëshmitarëve ekspert
19 për çështje kriminalistike dhe materiale të cilat kërkojnë
20 masa mbrojtëse.

21 Vërej që prej konferencës së fundit ZPS-ja ka nxjerrë një
22 paketë shtesë me materiale sipas rregullit 102(1)(b) dhe dy
23 paketa të cilat përfshijnë përkthime të materialeve të tjera,
24 por gjithsesi ka sërish ka materiale pezull të cilat do të
25 nxirren.

1 Dëshiroj të informoj palët që do të nxjerr një vendim
2 për kërkesën e 11 për masat mbrojtëse javën që vjen. Pas
3 përfundimit të afatit të 1 nëntorit për nxjerrjen e
4 materialeve sipas rregulli 102(1)(b). Kërkesa 12 për masa
5 mbrojtëse ose më mirë vendimi për kërkesën e 12 për masa
6 mbrojtëse do të lëshohet më pas.

7 Dëshiroj të dëgjoj nga palët se çfarë progresi është bërë
8 lidhur me nxjerrjen e materialit sipas rregulli 102(1)(b). Në
9 veçanti, dua që ZPS-ja të thotë sa nga ky material mbetet ende
10 për t'u nxjerrë dhe cilat janë dokumentet pezull, ende pa
11 nxjerrë në rregulli 102(1)(b) që duhet të nxirren.

12 Vërej se ZPS-ja kërkon zgjatje të mëtejshme të afatit
13 aktual deri më 31 janar 2022 për përfundimin e nxjerrjes së
14 materialeve dhe përkthimit të materialit të mbetur nën
15 rregulli 102(1)(b).

16 E ftoj ZPS-në që të japë detaje lidhur me afatin e
17 pritshëm për nxjerrjen e materialit të mbetur sipas rregullit
18 102(1)(b) dhe përfundimin e përkthimeve të këtij materiali.

19 Gjithashtu e ftoj ZPS-ja të na thotë se në qoftë se do të
20 bëhen kërkesa të tjera për masa të mëtejshme mbrojtëse në
21 përputhje me materialin sipas rregullit 102(1)(b) dhe të na
22 thotë sesi është ecuria lidhur me këtë material.

23 Zonja Prokurore, fjala për juve.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit shumë, i nderuar
25 Gjykatës.

1 Siç e kemi thënë edhe në parashtrimet me shkrim, sa i
2 takon volumit të materialeve, ne jemi thujse afër përfundimit
3 sa i takon materialeve që do të nxirren mbi bazën e rregulli
4 102(1)(b). Që prej konferencës së fundit janë nxjerrë tre
5 paketa të materialit sipas rregullit 102(1)(b) që janë
6 përkatësisht paketat 87, 103 dhe 105.

7 Lidhur me çfarë është bërë. Raportet e tri dëshmitarëve
8 ekspertë janë marrë dhe janë depozituar gjithashtu edhe
9 kërkesat për masat mbrojtëse përkatëse. Po ashtu kemi marrë
10 dhe pëlqimin lidhur me deklaratat e tri dëshmitarëve
11 ndërkombëtarë dhe këto materiale janë nxjerrë me përjashtimin
12 e një dokumenti, të cilin do ta shtjelloj pak më vonë.
13 Materiale të tjera të cilat lidhen me dëshmitarë që kanë qenë
14 objekt i kërkesave për ndryshim ose palëve të treta i kanë
15 marrë dhe i kanë nxjerrë po ashtu.

16 Ne nuk parashikojmë që të nxjerrim ndonjë paketë tjetër
17 materialit sipas rregullit 102(1)(b) përpara datës 1 nëntor. Ne
18 besojmë që të gjitha materialet që kemi pasur në posedim, në
19 zotërimin tonë, janë nxjerrë deri tani. Po ashtu nuk
20 parashikojmë kërkesa për masa të tjera mbrojtje të cilat kanë
21 të bëjnë me materialin sipas rregullit 102(1)(b).

22 Megjithatë, ka disa dokumente të tjera, pak dokumente për
23 të cilat do të duhet ende të marrim pëlqimin. Këto dokumente
24 specifikohen në paragrafin 12 të parashtrimeve me shkrim edhe
25 do t'i cek edhe tani gjatë fjalës time.

1 Kemi një provë materiale të një eksperti ndërkombëtar për
2 të cilin nuk kemi marrë pëlqimin, kështu që për këtë arsye ne
3 jemi në kontakt dhe në negociata të vazhdueshme me ofruesin e
4 këtij informacioni, në mënyrë që të marrim këtë pëlqim. Kemi
5 dy dëshmitarë lidhur me të cilët vendimet për ndryshim priten
6 ende për një pjesë të mirë të materialit; pra, këto kanë të
7 bëjnë me prova të mëparshme përpara një institucioni të tretë.
8 Të gjitha materialet e lidhura me këtë dëshmitar janë nxjerrë,
9 me dy dëshmitarët e tjerë janë nxjerrë. Së fundi, ne po presim
10 marrjen e versionit më pak të redaktuar ose të paredaktuar të
11 materialeve të mëparshme të nxjerra në lidhje me këta tre
12 dëshmitarë.

13 Kaq kisha për të thënë sa i takon materialeve sipas
14 rregulli 102(1)(b) të cilat janë ende pezull dhe për të cilat
15 kërkojmë një shtyrje. Secili prej këtyre dokumenteve janë
16 objekt i ndryshimit ose vendimeve për pëlqimin dhe për këtë
17 arsye, nuk jemi në gjendje që të themi saktësisht se kur do të
18 merren këto vendime dhe kur këto materiale do të merren.
19 Megjithatë, në momentin që të ndodhin këto gjëra, ne do t'jua
20 bëjmë këto me dije dhe do t'i nxjerrim këto informacione
21 menjëherë.

22 Po ashtu kemi bërë të gjitha përpjekjet tona që të
23 përshpejtojmë përkthimet e materialeve që janë pezull që bien
24 nën materialet e rregulli 102(1)(b). Siç kam thënë edhe më
25 përpara, ZPS-ja ka përcaktuar si përparësi përkthimin e këtyre

1 materialeve dhe jemi përpjekur që të përdorim burime maksimale
2 të përkthimit. Pra, ne kemi marrë hapa pasuese pas konferencës
3 në mënyrë që të mund të angazhojmë kapacitete maksimale.

4 Pra, kemi disa rezultate pozitive, megjithatë parashikimi
5 nuk është rritur në mënyrë të ndjeshme. Ne po merremi me
6 përpunimin dhe nxjerrjen e përkthimeve në një mënyrë graduale
7 dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë gjë. Që prej konferencës së
8 fundit janë nxjerrë katër paketa përkthimesh, më së fundi janë
9 bërë nxjerrje materialeve në kuadrin e paketës së përkthimeve
10 109. Dhe kjo ka çuar në përkthimin e 1.669 dokumentesh të
11 përkthyer.

12 Megjithatë, siç e kemi thënë edhe më parë, për shkak të
13 volumit dhe natyrës së dokumenteve parashikohet që përkthimi
14 sipas rregullit 102(1)(b) të mund të vazhdojë deri në fund të
15 dhjetorit të këtij viti.

16 Një numër i konsiderueshëm i dokumenteve të përkthyer
17 kërkojnë redaktime përpara sesa ato të nxirren dhe kjo në
18 vetvete kërkon kohë dhe kërkojnë rishikime të niveleve të
19 ndryshëm si edhe hedhjen e redaktimeve nga gjuha në origjinal
20 në gjuhën e përkthyer. Është një detyrë, që kërkon punën e
21 stafit gjyqësor dhe është një detyrë e cila nuk mund të
22 bazohet në një grup të vogël njerëzish.

23 Ne kemi identifikuar 31 janarin 2022 si afatin kohor për
24 përfundimin e përkthimeve që kërkojnë nën rregullin 102(1)(b).
25 Kemi kërkuar një shtyrje të afatit kohor për nxjerrjen e

1 përkthimeve deri më 31 janar.

2 Megjithatë, unë do doja të thosha që përkthimet do të
3 vazhdojnë që të nxirren në mënyrë graduale sapo ato të bëhen
4 të disponueshme. Sa i takon shifrave specifike ato i kam dhënë
5 në parashtimet me shkrim por mund t'i përmend edhe këtu nëse
6 dëshironi.

7 E kuptoj që do t'i kthehemi pikave specifike, të cilat
8 janë cekur në Mbrojtjen e z. Selimi, megjithatë, pavarësisht
9 domethënës, do të doja të cekja vetëm njërin prej këtyre pikave
10 që ka të bëjë megjithatë afatin kohor.

11 Avokati i z. Selimi nuk e kupton siç duhet kuadrin e
12 nxjerrjes së materialeve të zbatueshëm përpara kësaj Gjykate.
13 Askund në ligj apo në rregullore nuk kërkon afatin e
14 materialeve nën rregullin 102(1)(b) që të jetë paraprakisht
15 dorëzimi i dosjes paragjyqësore. Ndërkohë, ajo çfarë kërkohet
16 është që të paktën 30 ditë përpara hapjes së çështjes të mund
17 të dorëzohen dokumentet.

18 Kjo është gjithashtu edhe situata në gjykatë të ngjashme,
19 të cilat përdorin afatet për nxjerrjen e materialeve dhe
20 ndërkohë data sipas këtyre gjykatave është diku tre muaj
21 përpara fillimit të gjykatës.

22 Si rezultat, në kontrast, regjimi i afateve të aplikuara
23 në këtë rast, ku Mbrojtja ka marrë pjesën më të madhe të
24 dokumenteve nën rregullin 102(1)(b) është në mënyrë,
25 domethënës, se shumë herë më e favorshme për të akuzuarin sesa

1 aplikohet gjetkë edhe ndërkohë, të mundohesh që ta quash këtë
2 materialesh, që është avantazhuese për Mbrojtjen, si
3 paragjykuese është diçka e pasaktë dhe e padrejtë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Kehoe, fjala për ju.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Sigurisht që unë do të trajtoj disa
7 prej komenteve që u trajtuan nga Prokuroria, në veçanti lidhur
8 me efikasitetin e plotë dhe favorizimin e të akuzuarit.

9 Megjithatë, për momentin, do të doja që të përqendrohem
10 tek aspekti i parë për sa i takon materialeve sipas rregullit
11 102(1)(b). Dhe do të doja t'i thoja z. Roberts që ta marrë
12 fjalën, avokatit të z. Selimi, në qoftë se më jepni leje në
13 mënyrë që ai të filloj me parashtrimin e tij. Dhe pastaj ne ta
14 ndjekim atë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, z. Robert, fjala
16 për ju.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] E shoh që më dhanë leje kolegët
18 që të filloj.

19 Unë do të flas shumë shkurtimisht sepse pozicionin tim e
20 kam bërë shumë të qartë sa i takon nxjerrjes së informacionit
21 sipas rregullit 102(1)(b). Në terma të përgjithshëm nuk është
22 se kam shumë gjëra për të shtuar. Megjithatë një ndër gjërat
23 që u thanë këtu është që neve e kemi keqkuptuar kuadrin ligjor
24 për nxjerrjen e materialit 102(1)(b).

25 Dua të theksoj që në kuadrin -- në vendimin kornizë

1 tuajin, kam përshtypje, që mban datën 23 nëntor 2020 ju i keni
2 kërkuar Prokurorisë që të nxjerrë të gjitha materialet që bien
3 në rregullin 102(1)(b) deri në maj të këtij viti.

4 Dhe, kanë kaluar thujtse gjashtë muaj, që kur këto
5 dokumente do të duhet të ishin nxjerrë. Dhe për të qenë më i
6 saktë, thujtse kanë kaluar tetë muaj. Dhe është kaluar dyfish
7 koha që ju keni caktuar sa i takon nxjerrjes.

8 Sa herë që ne vijmë këtu, në konferencën për ecurinë e
9 çështjes, ajo çfarë ndodhë gjithmonë është që Prokuroria
10 kërkon zgjatje të afateve kohore. E marrin këtë zgjatje të
11 afateve prej jush. Kështu që, kjo jemi në një situatë të tillë
12 ku ne ecim përpara po ecim me ritme shumë, shumë të ngadalta.

13 I nderuar Gjykatës, unë vetë nuk jam vrapues. Por, nga
14 ana tjetër më duket sa më shumë lëvizim ne aq më tepër na
15 largohet pika e mbërritjes.

16 Kështu që nga ana ime, siç e thashë edhe më përpara, pa u
17 futur në detaje dhe në hollësi, lidhur me materialin nën
18 rregullin 102(1)(b) dhe lidhur me atë se çfarë i kërkojmë ne
19 Prokurorisë që të bëjë për sistemin Legal Workflow, më duhet
20 të them që nuk kemi bërë asnjë lloj progresi. Jemi tërësisht
21 në të njëjtën situatë. Dhe tani na kërkohet sërish që afati
22 kohor të shtyhet sërish deri më datën 31 janar të vitit që
23 vjen, sa i takon -- në qoftë se situata e tillë është
24 avantazhuese për neve.

25 Pra, në qoftë se procesi i nxjerrjes është me avantazhe

1 për neve, unë kam probleme me këtë term. Procesi me
2 avantazhet do të ishte një proces ku ZPS-ja ta kishte dhënë,
3 ta kishte nxjerrë materialin kur ishte kërkuar fillimisht prej
4 jush, pra, që në maj të vitit 2020.

5 Atëherë përveç parashtrimeve që kam dhënë me shkrim nuk
6 kam asgjë tjetër lidhur me materialin që duhet të nxirret
7 sipas rregullit 102(1)(b).

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe, fjala për ju.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës. Vetëm disa
10 çështje.

11 Pra, është shokuese për mua pozicioni i ZPS-së. Jam i
12 sigurt që edhe ju, Gjykatës, jeni i mërzitur me efikasitetin e
13 Zyrës së Prokurorisë, duke pasur parasysh që klientët tanë
14 janë burgosur që në vitin që shkoi. Dhe pavarësisht kësaj, ata
15 flasin dhe ju kërkojnë juve, i nderuar Gjykatës, që të zgjaten
16 kohët.

17 Flasin për një regjim që është më i favorshëm për neve?
18 Domethënë, kjo është qesharake.

19 Le të shohim ekzaktësisht se çfarë ka ndodhur. Avokati
20 koleg sapo tha që afati kohor fillestar ishte maji i vitit të
21 shkuar. E kuptoj, zoti Gjykatës, që ju e keni shtyrë më parë.
22 Megjithatë afati kohor fillestar ka qenë 31 maji. Çfarë ka
23 ndodhur?

24 Që për konferencës së parë për ecurinë çështjes, ne kemi
25 marrë 1732 dokumente. Kemi marrë vetëm mbrëmë 213 dokumente.

1 Që është gati 13 për qind e materialeve që kemi marrë ndërkohë
2 që klientët tanë vazhdojnë të jenë në burg edhe sot e kësaj
3 dite. Unë jam dakord plotësisht megjithatë z. Roberts, kur do
4 t'i vijë fundi kësaj gjëje?

5 Dhe, si mund të thotë një njeri me mendjen e plotë që ata
6 po bëjnë çdo gjë të mundur për të akuzuarit, ndërkohë që këto
7 dokumente vazhdojnë e vazhdojnë që të kërkojnë shtyrje
8 ndërkohë që klientët tanë vazhdojnë të mbeten në burg? Kur do
9 të vijë momenti dhe t'i thuhet palës tjetër që kjo është
10 shumë?

11 Dhe juve vazhdoni, të nderuar Gjykatës, që të jepni
12 urdhra ndërkohë që Prokuroria nuk e respekton këtë gjë. Tani
13 na kërkohet që afati të shtyhet deri më 31 janar. 31 janar.
14 Dhe kjo kërkohet për 760 përkthime në anglisht dhe rreth 1000
15 përkthime në shqip. Domethënë bëhet fjalë për 1700 dokumente
16 të cilët duhen përkthyer. Domethënë, flitej që gjykimi do të
17 fillonte këtë vit ose dhe më përpara ndërkohë që tani dëgjojnë
18 që deri më 31 janar ata duan që të shtyjnë këtë afat kohor.

19 Klienti im është burg. Ndërkohë jam i sigurt që ju e
20 kuptoni, i nderuar Gjykatës, por klienti im dëshiron dhe duhet
21 t'i ketë këto dokumente dhe ai nuk mund të përgatitet siç
22 duhet në qoftë se këto dokumente nuk i kanë në gjuhën e vet.

23 Atëherë, ne kemi gjithë këtë marrje dhe dhënie për
24 nxjerrjen e informacionit. Por nga ana tjetër kemi 327
25 dëshmitarë në listat e tyre dhe kemi 122 dëshmitarë që nuk

1 kemi identifikim dhe do të duket sikur flet me murin sepse
2 asgjë nuk është e kuptueshme. Pra, 122 dëshmitarë që i kemi pa
3 identifikim.

4 Domethënë, si do t'i vej halli kësaj pune? Do të kemi
5 rreth 122 dëshmitarë ende të paidentifikuar dhe t'i shkojmë
6 tek dera e Prokurorisë për t'i thënë? Na thoni si është
7 situata e favorshme për katër burrat që cilët vazhdojnë të
8 mbahen ende në burg? Kjo është qesharake.

9 Pra, duhet të ketë një pikë ndarëse se ata kanë vendosur
10 që t'i ndalojnë këta burra. Keni parasysh që më 31 janar do
11 t'i marrim dokumentet. Edhe jam i sigurt që përpara sesa të
12 kalojmë ky afat, do të marrim sërish një kërkesë tjetër për të
13 shtyrë afatin e tyre dhe do të kalojmë deri në mars.

14 Besoj që mjafton që të them, i nderuar Gjykatës, që ka
15 shumë dokumente të cilat nuk janë nxjerrë prej tyre. Dhe kemi
16 tetë dëshmitar për të cilët nuk kemi fare informacioni sipas
17 rregulli 102(1)(b). Nuk kemi asgjë për ta. Pra, mendoj që kjo
18 do të jetë pjesë e nxjerrjes së tyre.

19 Më duhet të them Gjykatës, që kjo zgjatje është cenuese,
20 është paragjyquese për klientët tanë, për klientin tim dhe të
21 thuash këtu sot që ky regjim i nxjerrjes është me avantazhe
22 është favorizues për neve. Kjo është qesharake.

23 I nderuar Gjykatës, ju lutem kërkojini ZPS-së që të
24 respektojë vendimet e marra ashtu siç bëjnë të gjitha palët e
25 tjera të cilat janë të pranishme në këtë sallë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Kehoe.

2 z. Emerson, fjala për ju.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kam ca
4 komente të përgjithshme për të bërë lidhur me listën e
5 dëshmitarëve që na është dhënë kësaj jave, megjithatë do ta
6 mbaj këtë diskutim për momentin e përshtatshëm.

7 A mund të them për qëllim të diskutimit të temës së parë
8 dhe kam përshtypjen, që kjo është e vërtetë për çdo gjë
9 tjetër, që do them më pas. Ka një elefant -- në qoftë se ka
10 një elefant në dhomë, ka diçka që nuk është në agjendë, diçka
11 e cila do të duhet që të shtyjë të gjithë vendimet tuaja dhe
12 duhet të jetë gjithashtu edhe një ndër parimet kryesore
13 udhëzuese për ZPS-në.

14 Z. Kehoe, e tha shumë troç, Prokuroria është organi që
15 mori vendimin që të arrestonte këta burra më shumë sesa një
16 vit më përpara dhe ata kërkuan mbajtjen e tyre të ndaluar për
17 më shumë sesa një vit dhe disa nga gjëra të duhet të vendosen
18 tashmë.

19 Kur ZPS-ja ka thënë, në një prej parashtrimeve të saj më
20 të më të vona, mbështetur në kërkesën për nxjerrjen e
21 materialit sipas rregulli 102(1)(b), që thotë që është
22 përgjithësisht në rrugën e drejtë, më duhet të përmend
23 parashtrimin që është bërë kam përshtypjen më datë 21, në mos
24 gabohem. Po, e kam fjalën për konferencës për gjendjen
25 gjyqësore të çështjes më 21 korrik. Dy ditë përpara afatit

1 kohor, dy përpara përfundimit të afatit për nxjerrjen e këtij
2 materiali ZPS-ja i thotë Gjykatës që është thelbësisht në
3 rrugën e duhur. Dy ditë përpara sesa të bëhej Konferenca për
4 Ecurinë e Çështjes në 21 korrik pretendon që është në rrugën e
5 duhur.

6 Pra, me gjithë respektin, kjo është gënjeshtër. Ishte
7 gënjeshtër. Dhe kur Prokuroria thotë në parashtrimet e pas që
8 "jemi në rrugën e duhur", ne nuk kemi asnjë arsye për të
9 besuar, që ndonjë gjë është e vërtetë aty, sepse Prokuroria,
10 që nga fillimi, nuk di sesi ta them në mënyrën më diplomatike
11 të jetë e mundur. Megjithatë, më lejoni ta rifrazoj dhe them
12 që në fillim fare, pra, Prokuroria ka pasur marrëdhënie
13 rastësore ekstreme me të vërtetën. Ata kanë gënjyer që në
14 fillim fare kur kanë bërë kërkesat për lëshim të përkohshëm në
15 pritje të gjyqimit dhe ju bindën juve se këta burra të cilët
16 janë në ndalim duhet të mbeten të tillë dhe se deri në fund të
17 vitit do të kishte zhvillim, pra, do të ishin, pra, gati për
18 procesin gjyqësor. Ata thanë që në fillim të janarit do ishin
19 të gatshëm për procesin gjyqësor.

20 Dhe nuk po them që është e vetmja gënjeshtër kjo. Po neve
21 akuzohemi që po ju çorientojmë po çojmë në drejtimin e gabuar
22 duke thënë që ne jemi pjesë e show-ve të cilat janë tërësisht
23 jorealiste. Megjithatë gjatë parashtrimit tim më vonë do t'ju
24 jap edhe një tjetër shembull të qasjes së Prokurorisë.

25 Unë dua të them që jemi lënë në një situatë të tillë dhe

1 siç e tha dhe kolegu im, ndoshta ata të bëjnë dallim ose jo,
2 por në fund të ditës, secili çdo minutë, çdo sekondë e orës
3 tani, ndërkohë që këta burra vazhdojnë që të jenë të ndaluar,
4 duhet të peshojë shumë fortë në mendimin tuaj, në mendjen
5 tuaj, i nderuar Gjykatës. Keni një vit, besoj, që mendoni por
6 jam i sigurt që Prokuroria do të vazhdojë që të mundohet t'ju
7 bindë juve që të vazhdojë që t'i mbajë këta burra në burg,
8 pra, në qoftë se nuk do të bëhet një gjë ky institucion do të
9 rezultojë një turp.

10 Do të rezultojë si një institucion që është i lirë që të
11 arrestojë njerëzit edhe kur nuk e ka idenë se çfarë do bëj ta,
12 një institucion i cili gënjen Gjykatën. Por nga ana tjetër, me
13 gjithë respektin, juve dëgjoni me endje, por nga ana tjetër
14 nuk thoni asgjë, nuk thoni asnjë koment sa i ta -- dhe nuk
15 kërkoni asnjë lloj shpjegimi lidhur me atë çfarë premtan apo
16 jo ZPS-ja.

17 Pra, Gjykata, ka dhe po jep pamjen e një menaxhimi shumë
18 të keq, në veçanti, sa i takon individëve të cilët mbahen të
19 ndaluar.

20 Pra, më 21 korrik ata thanë që janë në drejtimin e duhur.
21 Por për afatin deri më 23 korrik dhe deri në atë kohë, kam
22 përshtypjen që të akuzuarit kishin nëntë muaj që ishin të
23 ndaluar. por që prej këtij afati kohor në përgjithësi, në
24 total ZPS-ja ka nxjerrë 10.039 dokumente të cilat përbëhen nga
25 112.142 faqe bazuar në të cilën ZPS-ja mendon që do të

1 mbështetet në procesin gjyqësor, në gjykim.

2 Pra, të gjitha provat mbi të cilat ZPS-ja thotë që do të
3 mbështetet në gjykim, 80 për qind janë nxjerrë që prej kohës
4 kur ata ju gënjyen ju megjithatë datë 21 korrik. Pra, 80 për
5 qind e çështjeve të tyre është nxjerrë që prej asaj kohe e
6 deri tani. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që nëntë
7 muajt e parë të mbajtjes në burg ishte një gënjeshtër.
8 Gatishmëria dhe të qenit gati për të filluar procesin gjyqësor
9 ishte gënjeshtër po ashtu.

10 Dhe nuk e di sesi të duket ty si Gjykatës, por në qoftë
11 se do të isha unë në pozicionin tënd, po të isha unë Gjykatës
12 që gënjehesha nga Prokuroria, do filloja të humbja durimin.
13 Dhe sigurisht që do filloja të shikoja linja të tjera dhe
14 ndërkohë do të doja që të gjeja zgjidhje të tjera, ndërkohë që
15 Prokuroria vazhdonte pa fokuse dhe pa organizim në punën e saj
16 dhe të vazhdojë një proces që qëllimisht e ka bërë që këta
17 burra të rrinë në paraburgim një vit përpara se Prokuroria as
18 ka filluar të nxjerrë çështjen apo provat e saj.

19 Ne nuk e dimë se kur do të fillojnë hetimet e tyre. Po e
20 prek tani këtë çështje.

21 Dokumentet bazë të këtij Tribunali të cilat e bëjnë
22 plotësisht të qartë se ky është ngritur, është themeluar për
23 të gjykuar akuzat të përshkruara anembanë të raportit të
24 pagatitur, në fakt, raport plotësisht politik pseudo-hetim nga
25 një politikan që quhet Dick Marty, cili shkroi një raport që

1 përfshinte akuzat më absurde, më të paimagjinueshme sipas të
2 cilave UÇK-ja është angazhuar --

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, ju lutem mos
4 vazhdoni, nuk ka lidhje. Nuk ka lidhje. Atëherë futu drejt e
5 në temë.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më lejoni të mbaroj sepse aty do
7 të dal. Me gjithë respektin më të madh që kam për ju, është
8 një rrugë me dy pista.

9 Siç thashë përpara, shumica e gjykatësve në pozicionin
10 tuaj do ta kishin humbur durimin me Prokurorinë. Po mos e
11 humbi durimin me ne të Mbrojtjes. Më lejoni një apo dy minuta
12 derisa të shtjelloj pikat që doja të thosha.

13 Institucioni u themelua për të shqyrtuar këto akuza
14 absurde të cilat ishin të rreme. E dinim që u sajuan nga
15 dëshmitarë, të cilët i ka paraqitur zbulimi i fshehtë serb. Ne
16 e dimë me siguri sepse është provuar si fakt në TPNJ, në
17 gjyqin e Haradinajt.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, nuk ka fare
19 lidhje me këtë që po themi. Ne po flasim për afatin që ka të
20 bëjë megjithatë materialet e rregulli 102(1)(b). Ato që thatë
21 deri tani ishin në rregull të lidhura megjithatë temën. Po
22 këto që po thoni tani, nuk lidhen megjithatë temën.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po të keni durim të më dëgjoni.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kam durimin të dëgjoj të
25 gjitha palët.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë do të vazhdojë derisa të
2 përfundoj.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë unë mund t'ju
4 ndaloj.

5 Faleminderit shumë.

6 Ju lutem, futuni në temë. Do t'ju dëgjoj sa të doni, për
7 sa kohë që, së pari, t'i përmbaheni agjendës dhe, së dyti, të
8 flisni relativisht shkurt.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë po i përmbahem agjendës. Dhe
10 flas shkurtimisht. Po ju më ndërprisni.

11 Pra, kjo është baza, në bazë të cilës u themelua ky
12 Tribunal. Dhe askush nuk u habit që merr vesh sado pa nga
13 konflikti se Prokuroria nuk ka gjetur absolutisht asnjë provë
14 të mbështesë akuzat e saj.

15 Me fjalë të tjera themelet për ngritjen e këtij Tribunali
16 kanë qenë mbështetur në një gënjeshtër. Këtë e dimë të gjithë.
17 Ndërkohë Prokuroria këtë javë dhe, prandaj unë po futem tani
18 në temë. Këtë javë --

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do ta vlerësoja në qoftë se
20 nuk do ta kritikoni Trupin Gjykses, siç po më kritikoni mua.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë do ta vlerësoja po të
22 mos kritikoni.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë po ju them përmbajuni
24 agjendës.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju më ndërprisni dhe nuk kam

1 mundësi pastaj t'i përmbahem agjendës. Nuk mund të më hiqni të
2 drejtën e fjalës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk është ky qëllimi im.
4 Unë po ju kërkoj të jeni, të tregoheni i sjellshëm në këtë
5 sallë gjyqi.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] I sjellshëm jam.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo në asnjë sallë gjyqi nuk
8 do të t'ju lejonin të flisnit kështu. Qoftë në Mbretërinë e
9 Bashkuar apo në çdo tribunal ndërkombëtar.

10 Ju lutem, përqendrohuni ke tema dhe unë do t'ju dëgjoj.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e kuptoj pse mendoni se
12 është e pasjellshme nga ana ime kur përpiqem t'ju shpjegoj se
13 këto që them janë me vend. Më lejoni që t'i them të gjitha.
14 Padurimi juaj po drejtohet gabimisht se po flasim për të
15 vërtetën që ka ndodhur.

16 Pra, këtë javë, kemi marrë përmbledhjen e listës së
17 dëshmitarëve dhe përmbledhjet e dëshmitarëve dhe provat që ata
18 kanë ndërmend të marrin prej tyre.

19 Pra, askush nuk u habit se akuzat për themelimin e
20 Tribunalit ishin të pabaza. Ajo që na habiti të gjithëve dhe
21 ndërkohë procesi i nxjerrjes së materialeve ka qenë në vazhdim
22 dhe kjo është kristalizuar me nxjerrjen e listës së
23 deklaratave të dëshmitarëve. Ajo që na habit është se nuk ka
24 pretendime për pjesëmarrje, nxitje, shtytje apo ndihmë dhe
25 inkurajim në ndonjë krim, akt kriminal nga z. Veseli.

1 Ajo është e qartë kur lexon materialet është se
2 ndërmarrja kriminale e përbashkët që ata pretendojnë është në
3 vetvete Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ekzistenca e atij grupi.
4 Pse ka rëndësi? Sepse vetëm shumë së fundmi, kur u hap gjyqi i
5 Mustafës, Prokurori, z. Smith tha kështu:

6 "ZPS-ja nuk bën akuza kundër UÇK-së apo kundër luftës për
7 pavarësinë e Kosovës, nuk është as detyra, as dëshira e ZPS-së
8 apo e imja ta bëjmë një gjë të tillë".

9 E megjithatë, ne, me këtë po përballemi këtu. Nuk ka sesi
10 ta lexosh provën apo provat kundër z. Veseli apo të tjerëve
11 ndryshe përveçse të themi se ajo që Prokuroria po orvatet të
12 bëj është të krijojë një çështje që sipas së cilës UÇK-ja ka
13 qenë një ndërmarrje kriminale.

14 Kjo është me shumë mundësi për të gjitha çështjet e
15 programit, të agjendës, sepse po të fillojmë nga propozimi që
16 ata duan të provojnë, prandaj kemi një listë me 327
17 dëshmitarë. Dhe 327 dëshmitarë prej të cilëve vetëm 50 apo
18 diçka e tillë do të deklarohen viva-voce. Dhe kjo lidhet me
19 një gjyq që po vazhdon prej tre vjet e gjysmë.

20 Ju e mbani mend kur unë erdha këtu në fillim të kësaj
21 çështje dhe ju bëra disa vlerësime sesa do të vazhdonte faza
22 paragjyqësore bazuar nga përvoja ime në gjykata të tjera. Dhe
23 atëherë ishte kur Prokuroria bëri deklaratën e saj grandioze
24 dhe tani jemi më keq seç kisha parashikuar unë.

25 Pra, duhet të pranojmë se Prokuroria propozon një gjyq

1 prej tre vjetësh e gjysmë për të bindur Gjykatën se UÇK-ja
2 ishte një ndërmarrje kriminale në vetvete. Dhe këta burra të
3 cilët janë këtu, janë këtu jo sepse kanë bërë diçka po kanë
4 qenë politikanë të suksesshëm njerëz të shquar.

5 Dhe këtë e them pikërisht në bazë të provave që na janë
6 bërë të njohura.

7 Prokuroria, sigurisht, po përpiqet që të hartojë dosjen
8 e saj paragjyqësore sepse në një farë mënyre duhet të nxjerrë
9 diçka nga asgjëja. Të krijojë një çështje kundër këtyre katër
10 burrave nga hiçi. Pra, i jep vetes datën më të largët të
11 mundshme për të thënë që "e mbaruam në 2021" në 17 dhjetor kur
12 ky institucion do të mbyllet për të bërë pushimet e dimrit që
13 për Mbrojtjen nuk ka asnjë rëndësi, nuk i hyn në punë fare,
14 vetëm për të arritur një afat imagjinar që ata e kanë menduar.

15 Unë ju kërkova të urdhëroni 31 tetorin. Dhe ju nuk dhatë
16 asnjë vendim jo më në favorin tim. Unë e dërgova me shkrim po
17 prapë nuk kam marrë përgjigje. Pra, ne jemi sot këtu ku
18 Prokuroria thotë që deri në 17 dhjetor do të përpiqen të dalin
19 me diçka. Nga kjo baltovinë materialesh të themi se baltovinë
20 është.

21 Këta njerëz nuk kanë punë fare me këto që pretendohet.
22 Dhe ata janë në listë. Asnjë nga këta që janë në listë s'ka
23 lidhje me këta të pandehur. Është absolutisht një kënetë
24 kaotike që nuk bën dallim ndaj njeriut.

25 Dhe ata përpiqen të justifikojnë faktin që i kanë

1 arrestuar këto burra dhe kanë prova kundër tyre. Fakti që
2 Prokuroria ka pasur një vit në dispozicion dhe prapë nuk është
3 në gjendje të dalë, të deklarojë çështjen e saj është turp.
4 Por është më keq se kaq, sepse tani po thonë, deri në 17
5 dhjetor do ta kemi gati dosjen paragjyqësore, por nuk do të
6 mundemi të japim as materialet përfundimtare të rregullit 103
7 për të cilën ne kemi nevojë, as, ajo që ka rëndësi, materialet
8 e rregullit 101, sipas kërkesës së rregullit 109.

9 E cila kërkon nga Prokuroria që të kategorizojë
10 informacionin që i ka vërvitur Mbrojtjes në përputhje me
11 akuzat e Aktakuzës, me referenca konkrete ndaj krimeve bazë,
12 elementeve kontekstualë të krimeve, sjelljes së pretenduar të
13 të akuzuarve dhe sipas rastit provave që mund të paraqiten.
14 Pse se bëjnë dot tani? Sepse nuk e dinë. Nuk e kanë sajuar
15 akoma.

16 Ata mund ta kishin bërë këtë bashkë me dosjen
17 paragjyqësore. Në qoftë se dosja paragjyqësore do të ishte e
18 përgatitur si duhet, po ta dinin ata se cilat janë provat që
19 ata kanë, cila është çështja e tyre, nuk do kishte arsye t'ju
20 kërkonin shtyrjen deri në 17 dhjetor për të bërë lidhjen midis
21 provave dhe akuzave.

22 Çfarë mund të presim ne në 17 dhjetor? Një ngarkesë
23 tjetër materialesh të pakuptimta që ua paraqitën ju për të
24 përligjur arrestimet.

25 Megjithëse ka kaluar një vit që kur janë arrestuar këta

1 burra, të cilët u arrestuan para një viti. Dhe arrestimi i z.
2 Veseli dhe z. Thaçi u njoftua gjashtë muaj përpara për arsye
3 që s'kanë rëndësi, por që e bëjnë të qartë që vendimi për
4 arrestimin e tyre ishte marrë përpara sesa Prokuroria të
5 fillonte të shoshiste provat ndaj tyre. Ata e bënë për të
6 simbolizuar UÇK-në.

7 Ju keni të drejtë kur thoni, përmendni gjykatat
8 ndërkombëtare, po kjo është një sallë gjyqi ku audienca është
9 zona e Ballkanit dhe Kosovës, sepse kjo është gjykatë kosovare
10 dhe kosovarët duan ta dinë që drejtësia do të vihet në vend.
11 Gjithkush që merr vesh diçka, që ka një njohuri rreth këtij
12 konflikti e di se nuk ka pasur asnjë barazi midis politikës së
13 gjenocidit të regjimit të Millosheviçit që u fut në Kosovë dhe
14 i përzuri të gjithë shqiptarët e Kosovës duke i dërguar në
15 Maqedoni, Mal të zi dhe Shqipëri. Dhe nga ana tjetër, kemi të
16 bëjmë me rezistencën popullore e cila u rrit gradualisht pa
17 ndonjë organizim të madh për tu përpjekur për të ndaluar këtë
18 që po ndodhte.

19 Por ne e dimë që TPNJ-ja ka pasur juridiksion ndaj
20 Kosovës që nuk ishte specifik vetëm për një grup apo vetëm një
21 grup etnik siç është rasti në këtë Tribunal. Ajo gjykatë
22 gjykoi kriminelët serbë të luftës dhe kriminelët shqiptarë të
23 pretenduar të luftës. Dhe të gjithë kriminelët serbë u dënuan
24 për përfshirje në një konspiracion për të kryer krime kundër
25 njerëzimit fshat pas fshati, duke zhvendosur duke përzënë një

1 popullsi të terë jashtë kufijve. Dhe të gjithë të pandehurit
2 shqiptarë ose u liruan dhe një ose dy u dënuan me dënime shumë
3 të vogla.

4 Të njëjtët gjykatës, i njëjti tribunal po arsyeja pse
5 rezultati ishte i ndryshëm është sepse e vërteta ishte e
6 ndryshme. Ishte një grup njerëzish fermerë dhe të tjerë që
7 bënë ç'mundën për të mbrojtur veten. Dhe ky Tribunal monoetnik
8 i ngritur, pavarësisht nga fakti se ishte bërë një gjykimi
9 drejtë nga të dy anët, vetëm të përqendrohej te UÇK-ja. Tani
10 vijmë tek pika ku pas një viti në burg është e qartë për çdo
11 vëzhgues objektiv se Prokuroria vazhdon të mos ketë asnjë
12 argument në favor të saj.

13 Ju kërkoj ndjesë që ju fola kaq gjatë për t'a shpjeguar
14 si është situata por të gjitha këto tregojnë se supozimi mbi
15 të cilën mbështetet apo prezumimi i popullsisë nuk është një i
16 barabartë midis serbëve dhe UÇK-së dhe që kur njerëzit e UÇK-
17 së u dënuan në TPNJ nuk ka më nevojë të vazhdojë këtu.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

19 Tani ja jap fjalën, z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

21 Dua ta përdor kohën për të trajtuar një shembull konkret
22 lidhur me materialet e rregullit 102(1)(b), këtë e bëj sepse
23 është një shembull që mbështet atë u tha këtu në përgjithësi
24 që gjithçka duhet të lidhet me kohën që z. Krasniqi dhe të
25 tjerët po mbahen në paraburgim.

1 Përpara se të bëj këtë, vë re edhe pse jam këtu tani,
2 sapo na është dhënë paketa në bazë të rregullit 109. Mbas tre
3 paketave të tjera që na u dhanë dje dhe një ditë më përpara.
4 Në qoftë se do t'i shënojmë ditët kur na janë dhënë paketat me
5 materiale dhe t'i krahasojmë me datat që ju keni caktuar
6 konferencat për statusin, jam i bindur që keni për të parë që
7 aktiviteti është shtuar një ditë përpara konferencës për
8 statusin e çështjes, sikur nxitohen që t'i bëjnë punët për
9 t'ju bërë juve qejfin atë ditë.

10 Por gjëja konkrete që doja të sqaroja është përkthimi i
11 deklaratave në shqip.

12 Znj. Lawson, nuk i lexoi statistikën, po mbase unë do t'i
13 lexoj, është paragrafi 17 i parashtrimit të Prokurorisë ku
14 thuhet: Ka 10.400 [sipas përkthimit] deklarata të rregullit
15 102(1)(b) nga të cilat përkthimet në shqip të 1000 deklaratave
16 nuk i janë nxjerrë ende Mbrojtjes.

17 Pra, siç -- ndërkohë që z. Krasniqi rri në paraburgim
18 prej një viti, ai mund të lexojë vetëm më pak se 30 për qind
19 të deklaratave që thuhet se janë kundër tij. A është kjo një
20 çështje e re? Është diçka e habitshme? Jo, sigurisht, i
21 nderuar Gjykatës.

22 Në parashtrimet e tyre që u bën para jush në konferencën
23 e parë në 13 nëntor 2020 edhe parashtrimi 76, Prokuroria ka
24 thënë:

25 "ZPS-ja do të japë versionet në shqip të deklaratave të

1 gjithë dëshmitarët që do të përdorë në gjyq dhe aq sa është
2 maksimalisht e mundur do të japë përkthimet brenda të njëjtave
3 afate që kërkohet për të nxjerrë materialet në anglisht”.

4 Pra, afatet për të cilën flisnin ata ishte 31 maji, që
5 sigurisht, ka ikur, kanë kaluar disa muaj. Por ata e dinin që
6 në fillim të çështjes se kërkoheshin që këto deklarata t’i
7 jepnin në shqip me qëllim që z. Krasniqi të mund t’i lexonte.

8 Unë nuk po e kërkoj këtë nga qejfi. Por sepse kam marrë
9 udhëzime të klientit tim dhe duhet të di se kur të fillojë
10 hetimi dhe ai duhet të më udhëzojë.

11 Të kalojmë përpara. Ka kaluar pothuaj një vit. 11 muaj e
12 gjysmë deri sot kur Prokuroria në paragrafin 13 thotë:

13 “Përkthimi i materialeve të rregullit 102(1)(b) është
14 prioritarizuar prej muajsh”.

15 Z. Krasniqi ka gati një vit që është në paraburgim. Ç’ka
16 ndodhur përpara sesa të prioritarizoheshin këto deklarata? Dhe
17 për mendimin tim është e papranueshme dhe kjo mbështet edhe në
18 kundërshtimet e të tjerëve, që t’i mbash këto burra në
19 paraburgim për kaq kohë kur nxjerrja nuk po bëhet në mënyrën e
20 duhur, në mënyrën efikase, i nderuar Gjykatës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

22 T’i kthehem tani ZPS-së. Ju lutem, shkurtimisht. Në
23 mënyrë të përmbledhur.

24 Përpara se të merrni fjalën, shpresoj se mund ta
25 vazhdojmë këtë seancë pa tension dhe agresivitet midis palëve.

1 Faleminderit.

2 Znj. Lawson.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar

4 Gjykatës.

5 Për të qenë të qartë data për nxjerrjen e materialeve të
6 rregulli 102(1)(b) ishte 31 korrik 2021, jo 31 maj. Data e
7 korrikut u caktua jo si pasojë e kërkesës së Prokurorisë por e
8 kërkesës së Mbrojtjes që na kërkoi të bënim riklasifikimin e
9 dokumenteve dhe konkretisht nga Mbrojtja e Selimit.

10 Koha për paketat që duhen nxjerrë ka të bëjë me
11 materialet që merren, miratohen dhe përpunohen. Siç e di
12 Mbrojtja, ne kemi afatin për të nxjerrë materialet në 1 nëntor
13 dhe sigurisht kemi bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për
14 t'i marrë edhe për t'i nxjerrë dokumentet përpara asaj date.
15 Këtë javë janë nxjerrë disa paketa.

16 Paketa 109, që sapo është nxjerrë është një paketë që
17 përmban përkthime dhe kjo është në përputhje me angazhimin
18 tonë për të nxjerrë përkthimet pak nga pak posa që ne i
19 marrim.

20 Dhe lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit. Së
21 pari, e kanë keqinterpretuar atë që unë thashë. Komentet e mia
22 kishin të bënin konkretisht me afatet për nxjerrjen e
23 materialeve të rregullit 102(1)(b) që lidhen me dosjen
24 paragjyqësore. Aty është mbështetur në mënyrë të pasaktë edhe
25 Mbrojtja e Selimit edhe për ato unë u përgjigja.

1 Për sa i tako vëllimit të materialeve të nxjerra kohët e
2 fundit. Materiali i nxjerrë që nga konferenca për statusin e
3 21 korrikut, në të shumtën, janë nxjerrë menjëherë javët pas
4 asaj konference. Që i bie javët e para të gushtit.

5 Koha e nxjerrjeve ka ndodhur pak pas 31 korrikut për
6 shkak të një çështjeje teknike shumë të rëndë, gjatë të cilës
7 Workflow nuk ishte i disponueshëm për qëllimet e nxjerrjes dhe
8 për të cilën ne i kemi njoftuar palët. Po ashtu për sa i takon
9 materialeve të reja të rregullit 102(1)(b) shifra është 187
10 dokumente dhe jo mijëra dokumente.

11 Masat mbrojtëse po përdoren kur konstatojnë se janë
12 objektivist të justifikueshme. Ka një 203 dëshmitarë pa asnjë
13 vonesë në nxjerrjen e deklaratave të tyre. Identitetet e 21
14 dëshmitarëve të tjerë do të nxjerrën bashkë me materialet e
15 rregullit 94(4).

16 Për sa i takon paraburgimit, ky është subjekt i një
17 diskutimi të vazhdueshëm të veçantë. Kuadri ligjor ofron një
18 mekanizëm për shqyrtimin e rregullt të paraburgimit me të
19 drejtën për apelim.

20 Bazuar në shqyrtimin e fundit, të përfshirë nga Gjykata e
21 Apelit, rrethanat që përlligjin paraburgimin ekzistojnë si mbas
22 Gjykatës. Dhe shqyrtime të ardhme do vazhdojnë të bëhen bazuar
23 në themelsinë e çështjes si mbas kohës së përshtatshme.

24 Lidhur me objektin e kësaj çështjeje. Është një çështje
25 kundër katër personave, për shkak të përgjegjësisë individuale

1 kriminale të të katër të akuzuarve. Që Mbrojtja e Veselit të
2 përshkruajë keqtrajtimin dhe abuzimin e viktimave si një
3 çështje e parëndësishme është fyese dhe shumë e
4 papërshtatshme.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Emmerson. Do të keni të
6 drejtën të përgjigjeni më vonë.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mbrojtja e Veselit befas po
8 interesohet në materialet e rregullit 109. Unë dua të them se
9 të gjithë materialet janë nënkategorizuar nëpërmjet *Legal*
10 *Workflow* me shumë hollësi sesa në tabelën që përmendi avokati
11 i Veselit dhe ne do t'i kthehemi çështjes së tabelës kur të
12 vijë momenti i duhur.

13 Siç vutë në dukje me të drejtë, i nderuar Gjykatës,
14 parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit nuk kishin fare të bënin
15 me pikën e agjendës për të cilën po diskutojmë. Megjithatë, do
16 të flas për diçka dhe kjo është mënyra sesi avokati i
17 Mbrojtjes së Veselit bëri parashtrimet e tij.

18 Ata hedhin akuza lidhur megjithatë pandershmërinë. Është
19 kollaj të thuash, të bësh akuza të kota duke mos marrë
20 parasysh faktet bazë. ZPS-ja nuk ka thënë në parashtrimet e
21 saj se "ne jemi kryesisht në rrugën e duhur, lidhur me
22 materialet e rregullit 102(1)(b)". Nuk e di nga e ka marrë
23 këtë citim por nuk e kemi thënë ne këtë, këtë javë. Mund të
24 ketë thënë parashtrim -- që kanë qenë parashtrime të bëra më
25 herët në këtë.

1 Fakti është që kemi shumë shembuj kur Mbrojtja e Veselit
2 bën pohime të pasakta e faktike dhe ju përmbahet atyre me gojë
3 ose me shkrim edhe kur pasaktësia ju është vënë dukje. Dhe kjo
4 është keqpërfaqësim i qëllimshëm. Mbase parashtrimet bëhen në
5 këtë mënyrë për të tërhequr vëmendjen e medias për të gjithë e
6 dinë se shpesh ajo që kryeavokati i z. Veseli thotë nuk është
7 e vërtetë. Që palët të shpenzojnë kohën në këtë sallë gjyqi
8 duke shkëmbyer hipoteza dhe duke mos u sjellë me respektin e
9 duhur dhe siç e meriton një sallë gjyqi, nuk i shërben
10 drejtësisë apo viktimave të krimeve dhe nuk i bën shërbim as
11 të akuzuarve. Mënyra në të cilën Mbrojtja e z. Veseli i është
12 drejtuar Gjykatës është plotësisht e papranueshme dhe nuk
13 duhet të vazhdojë.

14 Faleminderit.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund t'i përgjigjem tani?

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po. Por në fillim z. Kehoe,
17 pastaj juve. Dhe ju lutem, në mënyrë të përmbledhur sepse
18 duhet të vazhdojmë me pikën tjetër.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Më duket se këtu jetojmë në një
20 univers krejtësisht tjetër.

21 Ajo që tha Prokuroria lidhur me rregullin 102(1)(b) ishte
22 se po e arrin fundin e punës aty por, ndërkohë, kjo është në
23 të keq të klientëve tanë që rrinë në burg. Kur do përfundojnë
24 ata?

25 Ata kërkuan zgjatjen e afatit për 1000 e ca dokumente,

1 dokumente në anglisht dhe mbi 700 - më fal - në shqip dhe mbi
2 700 në anglisht. Si nuk qenka kjo për të keqen e këtyre katër
3 burrave që rrinë në burg? Dhe kur thonë që "po i afrohem
4 fundit", e kanë thënë edhe më përpara. Ç'duan të thonë me këto
5 fjalë t'i afrojmë përfundimit? Për shumicën tonë kur thua që
6 po i afrohem fundit të punës do të thotë që shumë shpejt dhe
7 jo pas dy tremujsh se po kështu po thuhet tani. Edhe tre muaj
8 të tjerë përpara sesa të fillojmë t'i marrim 700 dokumente që
9 na duhen ne në anglisht dhe klientët tanë që duhet të marrin
10 1000 dokumentet që duhen përkthyer në shqip.

11 Jam i tronditur, në fakt, që Prokurorja ngrihet përpara
12 jush, që përpiqet të arsyetojë që s'e ka bërë si duhet. Në
13 qoftë se s'kanë përkthyes e kishin për detyrë të merrnin më
14 shumë përkthyes, t'i mbaronin hetimet. Hetimet janë në
15 vazhdim, do vijmë edhe aty. Por këta duhet t'i japin fund
16 kësaj pune. Ndërkohë që katër burra rrinë, dergjen në burg
17 Prokuroria kërkon thotë që po "i afrohem fundit". Kur thonë
18 fundit duhet ta përfundojnë punën.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk do të qortohtë kolegët për
20 keqorientimin e Gjykatës apo përdorimin e toneve tuaja por, në
21 fakt, kanë bërë deklaratatë të pasakta lidhur me kur Prokuroria
22 do të jetë gati për gjyq. Mua më akuzon ajo se kam
23 keqinterpretuar faktet, por ajo nuk na thotë asnjë shembull të
24 vetëm.

25 Ajo që kam thënë unë dhe, nëse ka kundërshtim, e ftoj që

1 ta shikojë transkriptin dhe të korrigjojë atë që do të thotë.
2 Ajo që thashë unë është që, në 21 korrik, në konferencën e 21
3 korrikut, kjo Prokurori premtoi, duke thënë jo të vërtetën, se
4 ishte kryesisht mirë me afatin për të përmbushur afatin e 23
5 korrikut, kur në fakt, nuk ishte kryesisht në rrugën e duhur.

6 Dhe kjo deklaratë iu bë juve.

7 Mbase juve s'pëlqen toni im, as asaj mbase s'i pëlqen po
8 të them të vërtetën nuk dua t'ia di shumë për këtë. Toni është
9 një gjë tjetër nga fjalët.

10 Unë e kuptoj që duke i kushtuar një vëmendje kaq të madhe
11 hollësive procedurale që ju duhet ta bëni për ta mbajtur në
12 rrugën e duhur çështjen, mund të jetë e vështirë që të ruash
13 një perspektivë të balancuar lidhur me mënyrën sesi këto
14 procedura perceptohen. Mund të jetë e vështirë kur futesh kaq
15 shumë në hollësira për të kuptuar saktësisht sesi një vëzhgues
16 objektiv e shikon mënyrën sesi sillet Prokuroria dhe mënyrën
17 sesi ata nuk kontrollojnë si duhet apo të menaxhojnë si duhet.

18 Në qoftë se ka ndonjë zhgënjim në mënyrën sesi unë i
19 parashtroj mendimet e mia duhet të ekzistojë. Është plotësisht
20 e arsyetuar. Dhe asgjë nuk e ndryshon mendimin tim përveçse në
21 raste kur mund të përdoret forca për ta detyruar për ta
22 kontrolluar Prokurorinë.

23 Pra, në qoftë se ata më akuzojnë mua se po flas shumë.

24 Kjo është për t'u habitur.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk të kam kritikuar për

1 këtë. Unë përmenda tonin në rastin tim, me mua z. Emmerson.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, unë nuk e kisha -- e kisha
3 fjalën që s'duhet të më ndërprisni sa herë që çohem.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.
5 Z. Roberts.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Në lidhje me këtë
7 pikën e fundit, një gjë shumë të shkurtër dhe në lidhje me atë
8 që e tha Prokuroria për afatin e parë për nxjerrjen e
9 materialit të rregullit 102(1)(b). Afati 31 maj 2021 ishte, që
10 urdhëruat ju, i nderuar Gjykatës dhe të cilin e shtyu Mbrojtja
11 deri më 31 korrik për shkak të kategorizimit.

12 Ajo që ne kërkuam dhe që ju miratuat ishte që Prokuroria
13 të nxjerrë materialin e rregullit 102(1)(b) në përputhje me
14 interpretimin e duhur të asaj dispozite ligjore, pra, të na e
15 kalojnë neve përgjegjësinë për vonesën e shkaktuar në
16 zhvillimin e procedurës.

17 Pra, ka vonesa dhe kjo na shkakton që mos arrijmë aty ku
18 duhet të jemi në këtë moment.

19 I nderuar Gjykatës, nxjerrja e materialit të rregullit
20 102(1)(b) është përgjegjësi e Prokurorisë. Jo e jona. Ne jemi
21 përpjekur që ta ndihmojmë Prokurorinë dhe do t'ju jap shembuj
22 për këtë më vonë sepse si duket ZPS-ja nuk është e zonja që të
23 identifikojë mënyrën si ta bëjë këtë punë vetë.

24 Dhe përpjekjet e ZPS-së që të na e kalojë përgjegjësinë
25 neve, është shumë e papërshtatshme në këto rrethana.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z.

2 Robertson.

3 z. Ellis, shkurtimisht ju lutem.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Në lidhje me pikën e fundit që
5 parashtroj z. Roberts, afati i 31 majit të këtij viti nuk doli
6 ashtu kot. Ishte një datë që Prokuroria ja sugjeroi Gjykatësit
7 të Procedurës Paraprake në parashtrimin F76. Pra, është shumë
8 e qartë se kujt i takon përgjegjësia për këtë vonesë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

10 Tani do të kalojmë tek kërkesa e Mbrojtjes së z. Selimi
11 në lidhje me nevojën që ZPS-ja së pari, të specifikojë në
12 sistemin elektronik *Legal Workfow* se cilat dokumente dhe
13 përkthime të rishikuara apo versione të redaktuara të
14 materialit të nxjerra paraprakisht kërkojnë rishikimin e
15 metadatave; krijimin subjekt të dëshmitarëve në sistemin e
16 *Legal Workflow* për të gjithë dëshmitarët që ndodhen në listën
17 paraprake të dëshmitarëve të ZPS-së.

18 z. Robertson, jua jap fjalën. Po, ju lutem, të jeni të
19 shkurtër, meqë keni bërë parashtrime të hollësishme me shkrim
20 dhe nuk ka nevojë të hyni në hollësi në lidhje me secilin
21 aspekt.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

23 Nuk do të hyj në hollësi përveç atyre që i kemi thënë në
24 parashtrimin tonë.

25 Unë kam identifikuar qartë se çfarë na duhet. Pse na

1 duhet. Dhe kam afruar mënyrën sesi të ndihmohet Prokuroria që
2 ta bëj këtë. Unë kam pasur përparësinë e përfshirjes në
3 krijimin e sistemit *Legal Workflow* para shumë kohësh në një
4 jetë të mëparshme si të thuash dhe mund ta ndihmoj
5 Prokurorinë këtë aspekt.

6 Ne jemi tani në një fazë kur kjo është më se e nevojshme
7 *Legal Workflow* është një sistem mjaft i ndërlikuar që ndihmon
8 nxjerrjen e materialeve, por dhe ka mënyra të ndryshme që ta
9 thuash këtë, është aq e mirë aq sa e ushqen apo varësisht nga
10 ajo çfarë fut në atë sistem. Dhe në qoftë se nuk e bën punën
11 mirë që nga fillimi, atëherë je në pozitë që të kesh ngecje
12 dhe vonesa.

13 Jemi në një fazë, siç thashë tani, ku duhet të arrijmë
14 objektivat konkrete dhe kur Prokuroria do të mund, shpresojmë,
15 t'i zbatojë kërkesat në mënyrë efikase dhe eficiente.

16 Faleminderit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, z.
18 Roberts.

19 Dhe marrë parasysh ofertën që bëtë që të bëni
20 këshilltarin e ZPS-jsë në lidhje me sistemin *Legal Workflow*.

21 Përpara se t'ia jap fjalën ZPS-së, dua që të pyes se
22 ekipet e Mbrojtjes në qoftë se kanë diçka për të shtuar apo
23 por të thënë më tej në lidhje me aspektet që preken në
24 parashtrimet e Mbrojtjes së z. Selimi.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar

1 Gjykatës.

2 Dhe ne i bashkohemi kërkesës së z. Selimi. Dua vetëm të
3 nxjerrë në dukje një aspekt praktik, ky është kalimi i
4 deklaratave të dëshmitarëve. Shumë shpesh numrat nuk përputhen
5 me ndonjë numër që është përputhës me dokumentin e nxjerrë.

6 Ndoshta mund të ndodhë që një dokument nuk është nxjerrë
7 në të njëjtën kohë me përkthimin apo është nxjerrë si pjesë e
8 një materiali tjetër të nxjerrë. Pra, në këto raste duhet të
9 kërkojmë fjalë për fjalë me mijëra faqesh dokumentesh në qoftë
10 se dokumentet nuk përputhen me përshkrimin që jep Prokuroria
11 në lidhje me deklaratën e dëshmitarit. E di që kjo ndoshta
12 tingëllon mjaft e elaboruar, por me siguri ekziston një mënyrë
13 më e mirë më e përshtatshme.

14 Dhe mendoj që z. Roberts, në parashtrimin e tij ka
15 paraqitur metodologjinë e *Legal Workflow* që duhet ta ndjekim.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kisha mundësinë që të diskutoj me
18 z. Roberts në lidhje me parashtrimet që i bëri ai me shkrim në
19 lidhje me këtë pikë dhe parashtrimet që do t'i bëj me sistemin
20 e nxjerrjes së materialit.

21 Unë qëndroj pas asaj që thotë ai tani gojarisht dhe asaj
22 që ka thënë në parashtrimet e tij me shkrim në lidhje me këtë
23 aspekt.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

25 Z. Ellis.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne i bashkohemi këtij
2 parashtrimi të z. Roberts.

3 Por paketat e dëshmitarëve dhe lidhja e dokumenteve me
4 deklaratat e dëshmitarëve është një temë që ju e keni dëgjuar
5 në mënyrë të përsëritur në shumë konferenca për statusin nga
6 Mbrojtja.

7 Me sa e kuptoj për momentin nuk ka kundërshtime në lidhje
8 me krijimin e këtyre lidhjeve midis subjekt dëshmitarëve dhe
9 deklaratave në *Workflow*. Kërkoj prej jush, të nderuar
10 Gjykatës, që ta urdhëroni Prokurorinë që të bëjë këtë, pra, të
11 sigurojë që identitetet e dëshmitarëve të lidhen me deklaratat
12 e tyre.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, z. Ellis.

14 Tani dua ta dëgjoj Prokurorinë lidhur me parashtrimin e
15 Mbrojtjes së z. Selimi për sa u përket këtyre tre aspekteve të
16 lidhjes së materialeve të rregullit 102(1)(b). Dhe
17 konkretisht, çështjen e paketave të dëshmitarëve sepse tani
18 kemi një listë paraprake dëshmitarësh që është nxjerrë dhe kjo
19 duhet t'u mundësojë palëve që të përdorin sistemin *Legal*
20 *Workflow* për këtë qëllim.

21 Urdhëro, zonja Prokurore.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua të korrigjo fakt. Fillimisht
23 kam përmendur datën 31 korrik por data për materialin e
24 rregullit 102(1)(b) ishte 23 korrik. Kishin dy afate të
25 ndryshme. Ne e mirëpresim ofertën e Mbrojtjes së z. Selimi për

1 një angazhim konstruktiv dhe jemi të gatshëm që të
2 konsultohemi në lidhje me çështjet që lidhen me *Legal*
3 *Workflow*.

4 Megjithatë ato çështje që identifikon Mbrojtja e z.
5 Selimi në parashtrimet e vete nuk janë bërë të ditura në
6 takimet *inter partes*. Me siguri që ka mënyra që ato çështje të
7 trajtohen në mënyrë më efikase. Ju, i nderuar Gjykatës, na
8 keni inkurajuar dhe më herët si palë që t'i trajtojmë këto
9 çështje që lidhen me aspekte të nxjerrjes së materialeve gjatë
10 takimeve ndërmjet palëve.

11 Çështja e parë që ngre Mbrojtja e z. Selimi lidhet me
12 dokumentet e redaktuara apo të rishikuar dhe lidhjen e tyre.
13 Dokumentet në sistem kërkohen në bazë të numrit të tyre të
14 regjistrimit ERN. Kur e kërkon numrin kryesor ERN, të gjithë
15 versionet e rishikuara dhe të redaktuara të atij dokumenti
16 bazë mund të nxjerren së bashku me metadatat shoqëruese.

17 Kur dorëzuar Paketën 82 dhe kjo paketë dokumentesh
18 përdoret konkretisht në parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes së
19 Selimit, ZPS-ja i dërgoi Mbrojtjes një email ku i shpjegoj
20 paketën e nxjerrë përkatëse dhe versionet e redaktuara dhe më
21 pak të redaktuar.

22 Ngjashëm, në lidhje me përkthimet. ZPS-ja identifikon
23 përkthimet e veta në sistemin *Legal Workflow* duke përdorur
24 shënimin "is translation" që "është përkthim" dhe me këtë
25 shënim shoqërohen edhe të gjitha përkthimet tjera që lidhen me

1 atë origjinal.

2 Gjithashtu, shtesa ET në fund të numrit të regjistrimit
3 të provës ERN bën të ditur se ai dokument është përkthim.

4 Për përfitimin e të gjitha palëve ne po bëjmë rishikimin
5 e të gjitha metadatave për të siguruar që përkthimet të lidhen
6 siç duhet me origjinalet.

7 Për sa i përket nënkategorizimit të materialeve. Mbrojtja
8 e Selimit ka identifikuar gjashtë dokumente për të cilat nuk e
9 ka të qartë nënkategorizimin dhe thotë që kategorizimi është
10 thjeshtë një lotari. Përsëri, një përdorim i gjuhës
11 hiperbolike. Ne nuk e përjashtojmë mundësinë që mund të kenë
12 ndodhë gabime gjatë kategorizimit, të kryer me dorë, të rreth
13 11.000 dokumenteve dhe ne do ta rishikojmë edhe njëherë
14 kategorizimin që përmend Mbrojtja e z. Selimi në parashtrimin
15 e vet. Megjithatë, ne kemi shënuar se cili i akuzuar lidhet me
16 cilin dokument. Në qoftë se ZPS-ja do të merrej vetëm me këtë
17 punë, pra, shënimin e emrit të të akuzuarit me lidhjen e atij
18 emri me një emër tjetër specifik që përmendet në dokument, kjo
19 nuk do të jepte ndonjë farë vlere të shtuar të thuash procesit
20 të identifikimit të provave.

21 Gjithsesi edhe pse për mendimin tonë kjo nuk do të
22 ndihmojë ndonjë gjë ne do të mundohemi që ta ndihmojmë
23 Mbrojtjen në çdo aspekt të mundur.

24 Së fundi, në lidhje me lidhjen e dokumenteve me
25 dëshmitarët. Në varësi të provave të miratuara mbrojtëse

1 pseudonimi i dëshmitarit përkatës përfshihet në përshkrimin e
2 deklaratave dhe dëshmime gojore dhe informacioni mund të
3 kërkohet nëpërmjet CSV dhe programit Excel.

4 Përveç kësaj në emailët që ZPS-ja ia ka dërguar Mbrojtjes
5 pas nxjerrjes së paketave të dokumenteve, në ato emaile ZPS-ja
6 tregon qartë se cila paketë lidhet me cilin dëshmitar.

7 Kur një provë nga ana tjetër ka të bëjë me më shumë
8 dëshmitarë ose lidhet me më shumë dëshmitarë, ne nuk mendojmë
9 që përdorimi i një pseudonimi, në atë rast, si përshkrim do të
10 ishte një zgjidhje e duhur. Referencat ERN në transkripte mund
11 të kërkohen në sistemin *Legal Workflow*.

12 Përveç kësaj, sikurse kemi thënë edhe më herët dhe
13 sikurse reflektohet në parashtrimet e Mbrojtjes së z.
14 Krasniqi, lidhja e materialeve me dëshmitarët në *Legal*
15 *Workflow* është diçka që është pjesë e diskutimeve *inter*
16 *partes*.

17 Pas dorëzimit të listës paraprake dëshmitarëve, ne do të
18 punojmë me njësitë përkatëse të Sekretarisë për të krijuar
19 subjekt dëshmitarë në *Legal Workflow*. Këtu, ndoshta do të
20 duhet, që disa prova materiale që mund të nxjerrin informacion
21 identifikues, të mos lidhen me dëshmitarët në këtë fazë.

22 Ka pasur edhe vështirësi teknike gjatë krijimit të
23 subjekt dëshmitarëve në sistemin elektronik në çështjet e
24 tjera, mirëpo po punohet që këto vështirësi teknike të
25 eliminohen.

1 Së fundi, konfirmojmë se jemi të gatshëm të marrim pjesë
2 në forumin e punës ashtu sikurse propozohet nga Mbrojtja e z.
3 Krasniqi.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, zonja
5 Prokurore.

6 Përpara se t'ia kaloj fjalën Mbrojtjes, a jeni në gjendje
7 të na jepni një farë orari apo propozim tjetër në lidhje me
8 afatet?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Subjekt
10 dëshmitari në sistemin *Legal Workflow* duhet të krijohen me
11 dorë individualisht për çdo dëshmitar dhe për lidhjen e atij
12 dëshmitari me provën përkatëse. Ne, gjithashtu, duhet të
13 kryejmë kontrole të kujdesshme për të siguruar që nxjerrja
14 apo shtyrja e nxjerrjes së informacionit të një dëshmitari
15 gjatë këtij procesi të mos cenohet.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
17 Prokurore.

18 Tani do t'i kthehem Mbrojtjes. Ndoshta i pari ju z.
19 Roberts, meqë ju e keni bërë kërkesën.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar
21 Gjykatës.

22 Në fakt, duket sikur është "jo", "jo" dhe në fund një
23 "po" ndaj të tre kërkesave që kisha, nga ajo që kuptova unë.
24 Sistemi sikurse thashë e mundëson një mënyrë më të lehtë për
25 lidhjen e versionit të redaktuara apo versioneve të mëparshme

1 për përkthimeve me deklaratën e një dëshmitari. Unë propozoj
2 që të ketë një farë qasje, për qasje sistematike në mënyrë që
3 ZPS-ja të sigurojë që puna të bëhet si duhet që në fillim në
4 mënyrë konstruktive.

5 Një gjë të fundit në lidhje me nxjerrjen e materialeve
6 krijimin e subjekt dëshmitarit në sistemin elektronik.
7 Sigurisht, që çështja e dëshmitarëve të mbrojtur është një
8 problem. Mendoj që Prokuroria tashmë ka bërë mend, se ka rreth
9 210 apo 220, nuk më kujtohet saktësisht, subjekte të
10 pambrojtura ose dëshmitarë në listën e tyre.

11 Në lidhje me këtë, nuk duhet të presim deri në mes të
12 dhjetorit për të marrë materiale. Mundet që materialet të na
13 dorëzohen pak nga pak sepse ne, pastaj, ato mund t'i vëmë në
14 përdorim për nevojat e përgatitjes së Mbrojtjes.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni, zonja Prokurore
16 në lidhje me këtë aspekt konkret që ngriti z. Roberts.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Lidhur me këtë pikë specifike, ne
18 pikërisht kështu e kemi ndërmend të vazhdojmë do të bëjmë
19 tërësimin e dëshmitarëve për të cilët nuk kërkohet shtyrja e
20 nxjerrjes së informacionit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
22 Prokurore.

23 Tani të kalojmë tek njoftimi i materialeve mbrojtëse
24 sipas rregulli 102(3).

25 Përkujtoj palët që më datën 14 tetor 2021, ZPS-ja kërkoi

1 zgjatjen e afatit kohor, së pari, në lidhje me materialet
2 kërkesën e rregullit 102(3) të dorëzuar nga Mbrojtja e z.
3 Krasniqi më 7 tetor; dhe, së dyti, me materialet apo
4 rishikimin e materialeve në lidhje me kërkesa të mundshme në
5 të ardhmen të Mbrojtjes.

6 Më datën 18 tetor 2021, unë pezullova afatet e ZPS-së në
7 lidhje me kërkesën e Krasniqit dhe ato që kishin të bëjnë me
8 rishikimin e materialitetit që atij materiali.

9 E urdhërova Mbrojtjen dhe përfaqësuesin e viktimave që të
10 paraqesin parashtrimet e tyre në lidhje me kërkesën e ZPS-së
11 për zgjatjen e afatit.

12 Nga parashtrimet e ZPS-së, e kam të qartë se ajo
13 rithekson kërkesën për zgjatjen e afatit për rishikimin e
14 masave mbrojtëse dhe për shqyrtimin e thelbësisë së materialit
15 në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes së z. Krasniqi dhe për një
16 zgjatje të përgjithshme për të të gjitha afateve të rregullit
17 102(3).

18 Në lidhje me këto tre kërkesa të Mbrojtjes së z. Veseli
19 të parashtruar më 16 dhe 22 tetor, ZPS-ja më tej kërkon një
20 zgjatje të afatit për rishikimin e thelbësisë së materialeve
21 dhe të masave mbrojtëse deri më 1 dhjetor dhe 17 dhjetor 2021.

22 Gjithashtu, theksoj se Mbrojtja e z. Selimi kërkon që
23 materiali i rregullës 102(3) të nxirret plotësisht; kurse
24 Mbrojtja e z. Krasniqi kërkoi që me 5 nëntor të vitit 2021 të
25 jetë dhe afati i fundit në lidhje me materialin që duhet

1 nxjerrë sipas rregullit 102(3).

2 Tani kërkoj parashtrimet e palëve në lidhje me këto pika.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sikurse thamë deri tani

4 Prokuroria ka marrë 15 kërkesa sipas rregullit 102(3). Deri

5 tani janë përpunuar 10 prej tyre. Dhjeta, është ajo që

6 përmendi Mbrojtja e z. Selimi, pra, nxjerrja e Paketës 108 sot

7 dhe kërkesa përmasa mbrojtëse përkatëse gjithashtu është

8 dorëzuar në lidhje me dorëzimin 552.

9 Nga pesë kërkesat që ende nuk janë zgjidhur katër janë

10 marrë gjatë dy javëve të fundit dhe kanë të bëjnë me 16.154

11 dokumente.

12 ZPS-ja mban parasysh parashtrimin e z. Krasniqi në lidhje

13 me kërkesën si pas rregullës 102(3) që do të ketë të bëjë me

14 një numër të ngjashëm dokumentesh, pra, rreth 8.000.

15 Gjithashtu, Mbrojtja e z. Selimi ka paraqitur se ka bërë

16 të ditur se të bëjë një kërkesë për rreth 40.000 prova dhe kjo

17 kërkesë do të bëhet në kohën e duhur.

18 Ne për momentin po shqyrtojmë kërkesën e z. Krasniqi në

19 lidhje me 5945 dokumente.

20 Për sa i përket kërkesë së z. Selimi. Për fat të keq, ka

21 disa deklarata të pambështetura në lidhje me procesin e

22 rregullit 102(3) përgjithësisht. ZPS-ja nuk e konteston faktin

23 që procesi parashikon një detyrë që kryhet në disa faza,

24 megjithatë, deri më sot Mbrojtja e Selimit nuk është angazhuar

25 efektivisht në këtë proces edhe pse e ka pasur këtë njoftim të

1 rregullit 102(3) ka tash tre muaj. Ajo e ka bërë kërkesën
2 vetëm tani lidhur me 123 dokumente.

3 Disa prej këtyre dokumenteve mund të kërkoen edhe më
4 herët në mënyrë që ato të dorëzoheshin pak nga pak sikurse
5 edhe u përmend në konferencën e gjendjes të fundit.

6 Dy të tretat apo më shumë të materialeve të paraqitura në
7 njoftim janë dorëzuar *inter partes* gjatë javës së fundit
8 brenda së cilës lejohet edhe kërkesa.

9 Për sa i përket marrëseve të nxjerrjes së materialeve
10 sipas rregullit 102(3), në qoftë se nuk janë kopjuar në
11 adresën e emailit ekipet e tjera ose në qoftë se nuk është
12 thënë ndryshe në një kërkesë, nxjerrjet lëshohen vetëm --i
13 dërgohen vetëm palës kërkuese.

14 Kemi marrë deri tani vetëm një kërkesë të përbashkët të
15 rregullit 102(3) dhe kjo ka qenë dikund në shkurt. ZPS-ja
16 mirëpret kërkesa të përbashkëta që do ta koordinonte edhe
17 punën midis ekipeve Mbrojtësve dhe e ftojme Mbrojtjen që të
18 bëjë kërkesa të tilla të përbashkëta.

19 Pra, kjo është tërësisht ndryshe nga rregulli 102(1)(b)
20 dhe rregulli 103 ku ekziston detyrimi pozitiv për Prokurorinë.

21 Me materialin sipas rregullit 102(3) i takon Mbrojtjes që
22 të përzgjedhë dokumente të cilat janë materiale për arsye të
23 përgatitjes së tyre. Fakti që kemi mijëra dokumente të cilat
24 janë nxjerrë bazuar në këtë rregull dhe shumë të tjera janë
25 kërkuar, tregon që kjo është e mundur.

1 Për më tepër, ZPS-ja ka shpenzuar rreth nëntë muaj për
2 t'i dhënë njoftim të detajuar Mbrojtjes dhe për të përpunuar
3 dokumentacionin e dorëzuar.

4 Në rrethanat përkatëse, kërkesa jonë është që Mbrojtjet
5 të mund të bënin kërkesat për dokumentet që kanë të bëjnë me
6 njoftimin sipas rregullit 102(3) deri në 5 nëntor. Më pas ZPS-
7 ja duhet të ketë mundësi që të përpunojë këto kërkesa dhe
8 kohën e nevojshme për t'i përpunuar ato.

9 Ne vërejmë që Mbrojtja për z. Krasniqi kërkon shtrirje,
10 zgjatje të afatit dhe nuk e kundërshtojmë atë në qoftë se
11 gjendet me vend prej jush, i nderuar Gjykatës. Ne e dimë, pra,
12 në momentin kur të dimë volumin e dokumenteve që kërkohet
13 atëherë mund të bëjmë parashtrimet përkatëse.

14 Ne kërkojmë, gjithashtu, që ndërkohë afatet e përpunimit
15 të mbeten të pezulluar me mirëkuptimin që ne të vazhdojmë të
16 punojmë me kërkesa që do të marrim në mënyrë sa më efikase të
17 jetë e mundur.

18 Faleminderit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
20 Prokurore.

21 z. Kehoe.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe njëherë, i nderuar Gjykatës,
23 jam i mahnitur.

24 Pra, Prokuroria kërkon që të na bëjë ne përgjegjës për
25 kërkesat për materialin sipas 102(3) ndërkohë që ata nuk kanë

1 bërë nxjerrje të materialeve të mëparshme mbështetur në
2 rregulli 102(1)(b), që është një pozitë mbresëlënëse për t'u
3 artikuluar këtu në Gjykatë.

4 Ata po ju kërkojnë juve që të shtyni nxjerrjen e një
5 pjese të materialit sipas rregulli 102(1)(b) deri në fund të
6 korrikut por të sigurohen që juve të na kërkonin në llogari dhe
7 që ne të respektojmë afatet kohore të zbatueshme. Kjo është
8 qesharake.

9 Gjykatës, ata kanë marrë deklaratat dëshmitarësh më pak
10 sesa dy javë më përpara që i kemi marrë si pjesë e këtyre
11 paketave. Ne nuk e dimë fare se çfarë kanë ato dokumente, 732
12 dokumentet që do të përkthehen në anglisht. Kështu që, në këtë
13 kuadër si supozohet që ne të mund të japim njoftim sipas
14 rregullit 102(3)?

15 Pra, në vend -- ne në fakt i kërkojmë me respekt Gjykatës
16 që të përcaktojë afatin, që të mbajë ata përgjegjës sa i takon
17 respektimit të afatit në mënyrë që të kemi një diskutim
18 racional për të ditur se sa kohë do të duhet që të kalojmë
19 këtë informacion dhe çfarë lloj njoftimesh parashikojmë ne.
20 Pra, dua ta them edhe njëherë troç, ne nuk e dimë sesa
21 material do të marrim? Kështu si mund t'ju japim ne një listë
22 të plotë të dokumenteve që kërkohen sipas rregullit 102(3)?

23 Pra, thjeshtë jam shumë i sinqertë me juve. Pra,
24 Prokuroria të thotë që ne duhet të respektojmë afatin kohor,
25 domethënë është e paimagjinueshme. Në qoftë se do ta mendojmë

1 këtë në mënyrë racionale dhe në qoftë se Prokuroria do të
2 vazhdojë që të shtyjë nxjerrjen e materialeve, atëherë,
3 ndërkohë e njëjta gjë do të duhet që të aplikohet edhe në
4 rastin tonë sa i takon kërkesës së informacionit që kërkohet
5 sipas rregullës 102(3). Kjo është logjike dhe kjo parashikohet
6 edhe në rregullore.

7 Pra, përveç gjërave që duhet të bëjmë, sepse nuk dimë se
8 ç'a do të bëjmë, neve ju kërkojmë që ju të përcaktoni këtë datë
9 derisa ne të dimë më mirë se çfarë dokumentacioni, çfarë
10 materiale do të jenë si pjesë e materialeve që do të nxirren.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] z. Emmerson, fjala për ju.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të
13 filloj nga themeli këtu, sepse duket sikur kjo kategori
14 provash, le ta quajmë, bazë të dhënash, një bazë të dhënash
15 nga e cila Prokuroria ka përzgjedhur prova që ajo dëshiron të
16 përdorë gjatë gjykimit ose që Prokuroria i konsideron ndihmëse
17 për Mbrojtjen.

18 Pra, si rregull i përgjithshëm dhe në përvojën time të
19 përgjithshme nuk është asnjëherë e zgjuar për Gjykatën që të
20 mbështetet mbi Prokurorinë për të vendosur se çfarë mund të
21 ndihmojë Mbrojtjen, sepse Prokuroria nuk e di se çfarë është
22 Mbrojtja, nuk e di se cilat çështje mund të jenë me rëndësi
23 për Mbrojtjen dhe së dyti, ka të ngjarë që të kenë pikëpamje
24 më të ngushtë të mundshme sa i takon materialitetit të
25 provave. Kështu funksionon bota.

1 Në pjesën më të madhe të juridiksioneve, Prokuroria ditën
2 të sotme, thjeshtë, Prokurorisë i kërkojë që të nxjerrë
3 materialet e veta në mënyrë që Mbrojtja të ketë qasje në të
4 gjitha dokumentet, t'i lexoj ato, të kuptoj se cilat janë këto
5 materiale dhe të përcaktojë se cilat nga këto materiale janë
6 më të rëndësishme për t'u përdorur prej saj. Pra, në fund kjo
7 nuk është se do të ndodhi këtu.

8 Dhe nuk është se do të futem në hollësi shumë, megjithatë
9 dua t'ju sugjeroj fundin dhe dua të them, që z. Roberts ka të
10 drejtë, që mënyra e vetme për ta zgjidhur këtë është thjesht
11 të bëjmë një kërkesë tani ose deri më datë 5 dhe të shohim
12 sesa kohë do t'i duhet Prokurorisë për ta bërë këtë gjë.

13 Pse e them këtë? Sa për të qenë i qartë, së pari, ne kemi
14 marrë vetë listën. Ne, që prej kohës që kemi marrë listën,
15 kemi bërë kërkesa për 7.785 dokumente. Këtë kërkesë e kemi
16 bërë më 21 gusht, ndërkohë kemi bërë kërkesë për 2.202
17 dokumente më 16 tetor, 2805 dokumente më 19 tetor, 26.892
18 dokumente më 22 tetor. Dhe këto, në fakt, mbështeten në
19 kritere shumë të vogla, në kritere të cilat janë mbështetur në
20 indeksin për të na treguar neve që ndoshta këto dokumente
21 lidhen me klientët tanë. Domethënë, ky në vetvete është një
22 proces shumë sipërfaqësor.

23 Numri i përgjithshëm i kërkesave që, siç e dëgjuat juve,
24 përmbledhen në mijëra dokumente, pra, nga e gjithë kjo mori
25 dokumentesh ne deri tani kemi marrë 19.

1 Më 25 tetor, pra, vetëm pak ditë më përpara ZPS-ja më në
2 fund na dha një njoftim të ndryshuar me përshkrime më të plota
3 por këtë e bëri vetëm për 25.000 dokumente. Ose për të qenë më
4 i saktë për 24.842 dokumente që ishin pjesë e listës. Siç e
5 kuptuam ne, në qoftë se ne do të detyroheshim në këtë
6 procedurë të çmendur, pra, neve do na duhej që të merrnim një
7 vendim për këto 25.000 dokumente dhe të bënim, le të themi,
8 një gjykim deri të hënë ose të martën për këto dokumente në
9 qoftë se ato ishin me interes për neve apo jo. Dhe kjo në
10 vetvete është e paarsyeshme.

11 Pyetja që na del ne është kjo: Pse ekziston afati kohor?
12 Pse ka kufizime afatesh kohore?

13 Afati kohor për ne është i rëndësishëm, sepse është e
14 dukshme që ajo që është me rëndësi për ne, si Mbrojtje, do të
15 ndryshojë me kalimin e kohës. Pra, do të ndryshojë me ofrimin
16 e dosjes paragjyqësore. Do të ndryshojë, gjithashtu dhe me
17 ofrimin e dokumenteve në rregullin 109. Do të ndryshojë me
18 dokumentin me nxjerrjen e vonuar në janar. Por mbi të gjitha
19 do të ndryshojë gjatë hetimit edhe nuk mendoj që është
20 absolutisht e pamundur që të fillohet gjykimi deri i fundi i
21 2022-shit.

22 Pra, bëhet fjalë për 300 dëshmitarë *viva voce* të
23 Prokurorisë. Dhe duke marrë parasysh sesa kohë i është dashur
24 Prokurorisë deri tani, është e qartë që procesi i hetimit do
25 të kërkojë të paktën një vit për Mbrojtjen.

1 Ndërkohë, ndërsa ne bëjmë hetimet dhe, këtë po thosha dhe
2 më përpara dhe ishte e rëndësishme dhe nuk duhej të lihej
3 mënjanë. Pra, ideja është që, në qoftë se do të kishte pasur
4 një çështje për të akuzuarit ose të paktën për klientin tim,
5 në qoftë se do ta kishin të përcaktuar çështjen nuk do na
6 duhej që të shqetësoheshim për 185 ose 285 dëshmitarë, do të
7 përqendroheshim vetëm në disa prej tyre. Dhe kështu ka
8 funksionuar, në fakt, në të gjitha Prokuroritë që janë marrë
9 me krimet e luftës. Dhe, në përgjithësi, provat për krimet,
10 baza e provave në përgjithësi janë dakorduar dhe mbi këtë bazë
11 është vijuar. Ndërkohë, që në rastin aktual, ne, nuk është se
12 kemi asnjë lloj informacioni të tillë.

13 Domethënë, në vend që të na e lehtësojnë punën, puna jonë
14 bëhet shumë herë më e vështirë. Tani çfarë ka në këtë arkiv të
15 madh? Dhe një gjë e rëndësishme mund të dalë në çdo kohë të
16 caktuar, domethënë, del nga dëshmitari që thotë kam qenë në
17 këtë situatë, kam dhënë një intervistë X, Y-it dhe duhet parë
18 baza e të dhënave.

19 Pra, më duhet të them që 5 nëntori është qesharak. Jo
20 vetëm kaq por edhe 5 dhjetori, edhe 5 janari madje edhe 5
21 dhjetori i 2022 është qesharak. Dhe ajo çfarë është e
22 rëndësishme për drejtësinë, rregullsinë e procesit, është që
23 ne të kemi qasje në të njëjtën mori informacioni që ka ZPS-ja.
24 Kjo është barazi armësh. Pra, ata kanë bërë përzgjedhjet e
25 tyre nga materiali. Ne duhet të bëjmë përzgjedhjen tonë. Duhet

1 të kemi mundësi që të lexojmë të gjithë atë informacion, të
2 gjitha ato dokumente.

3 Dhe nuk i takon ZPS-së që të vendosë apo të na kërkojë
4 neve se cilat janë ato dokumente mbi te cilat ne do të
5 mbështesim pozicionin tonë apo të fillojë që të na japë X
6 dokumente, 90 dokumente p.sh., që ka në posedimin e saj.

7 Pra, e vetmja mënyrë sesi mund të ta trajtoni këtë gjë
8 është që juve, i nderuar Gjykatës, të thoni: Tani ka ardhur
9 piku. Pra, ZPS-ja duhet të bëjë punën e vet. Nuk mund të
10 shtyhet më kjo gjë. Domethënë, gjithë përgatitja ishte e
11 parashikueshme. Këtë punë duhet ta kishin bërë më përpara.

12 Dhe sigurisht edhe gjatë gjykimit do na duhet kjo bazë e
13 të dhënave, sepse dëshmitarët mund të thonë p.sh., mund të
14 vijne këtu dhe mund të thonë që "Kam qenë në Shqipëri në një X
15 pjesë të Shqipërisë gjatë kësaj kohe" dhe na duhet që të
16 kontrollojmë atë bazë të dhënash. Ne kemi absolutisht të
17 drejtë që kemi qasje tek të gjitha dokumentet. Kështu që nuk
18 ka absolutisht asnjë lloj arsye pse të mos kemi qasje në këto
19 dokumente. Dhe besoj se flas në emër të kolegëve të mi, të
20 avokatëve të tjerë, kështu që neve duhet ta kemi atë.

21 Kështu që mos bëjmë lojëra fjalësh, pra, ata të na japin
22 ne, udhëzime për përshkrimet, të bëjnë kërkesa për afatet
23 kohore, e tjerë, e tjerë. Pra, duhet që të sigurojmë procesin
24 e rregullt ligjor.

25 Në qoftë se ata thonë që nuk mund ta bëjnë dot një gjë të

1 tillë se nuk kemi gjë gati, mendoj, që kjo në vetvete tregon
2 që ata nuk respektojnë detyrën që kanë. Por, në qoftë se i
3 kanë dhe nuk na i japin këto informacion dhe në qoftë se ju
4 jepni vendimin ata do të kenë mundësi që shumë shpejt t'i
5 nxjerrin këto informacione tek neve. Dhe ata duhet që të kenë
6 parashikuar nevojën për masa mbrojtëse për redaktimet.

7 Dhe kjo është një punë e cila duhet të ishte bërë përpara
8 sesa të arrestoheshin këta burra. E gjithë kjo punë duhet të
9 ishte bërë që më përpara. Nuk ka vlerë që të thuhet tani që
10 "Do na duhet shumë kohë për t'i bërë të gjitha këto se nuk i
11 kemi burimet në dispozicion".

12 Ju kërkoj ndjesë dhe ju kërkoj falje, në qoftë se nuk e
13 pëlqeni tonin e zërit tim, mënyrën sesi i drejtohem Gjykatës.
14 Por, më duhet të them që ne po kritikohemi, të gjithë ne, po
15 kritikohemi nga Prokuroria sepse përdorim hiperbola. Hiperbola
16 do të thotë ekzagjerim, do të thotë ta zmadhosh situatën. Por
17 ajo çfarë po thonë ata nuk është hiperbolë në qoftë se e
18 vërteta nuk përkon me të.

19 Unë, personalisht, jam i sigurt që pavarësisht që ju
20 thoni apo nuk thoni në publik, ju vetë jeni i shokuar nga
21 mënyra sesi po sillet Prokuroria, duhet të jeni të shokuar.
22 Dhe ne vetë, jemi shumë të zhgënjyer, që ju nuk keni thënë
23 asgjë publikisht në mënyrë që ZPS-në ta mbani përgjegjëse ose
24 me fjalë të tjera, ta ekspozoni këtë kaos dhe të tërhiqni
25 vëmendjen e tyre.

1 Megjithatë pavarësisht kësaj, unë personalisht, pra, jam
2 përjashtim. Nga ana tjetër më duhet të them, që unë, në
3 vetvete mendoj që çdo fjalë që del nga goja ime është e
4 justifikuar nga fakti që këta burra janë në burg. Dhe fakti që
5 nuk dëgjojmë as keqardhje më të vogël që këta burra janë
6 burgosur pa asnjë bazë të përcaktuar. Unë, personalisht,
7 mendoj që ishte më mirë që toni të jetë emocional sesa të jesh
8 në një situatë kur Prokuroria çohet në këmbë dhe është dhe
9 përfaqëson një organizatë e cila po dështon në një masë të
10 jashtëzakonshme.

11 Është një organizatë që nuk është në lartësinë e detyrës
12 së saj dhe thotë që kjo është situatë normale dhe, pastaj, ne
13 kritikohemi për përdorimin e hiperbolave. Më vjen keq. Ajo
14 është zëdhënëse e mirë. Në kuptimin që nuk ka asnjë shenjë
15 keqardhje për këto burra. Asnjë shenjë respektimi drejtësie.
16 Dhe në atë moment që e kalon këtë pjesë, atëherë ankohet për
17 ne.

18 Ajo është këtu për të bërë, për të mbrojtur atë çfarë nuk
19 është e mbrojtshme.

20 Kështu që në këtë kuptim, sa i takon dokumenteve,
21 zgjedhja dhe e vetmja zgjedhje, që mund të pranohet prej nesh,
22 dhe do ta bëj këtu përpara Gjykatës, unë kërkoj që të gjitha
23 ato dokumente të më jepen brenda afatit kohor.

24 Besoj që përfaqësoj këtu edhe kolegët e mi.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shoh që ka shkuar ora 16.17

1 ka përshtypjen që përkthyesit kanë nevojë për një pushim.

2 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e
3 Gjykatës këshillohen]

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më thuhet që duhet të
5 bëjmë pushim. Ora është 16.17 do të mblidhemi sërish në orën
6 16.45, 28 minuta pushim.

7 Seanca ndërpritet.

8 --- Pauza fillon në orën 16.18

9 --- Seanca rifillon në orën 16.46

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Besoj se dëgjuam nga dy
11 ekipe Mbrojtjeje lidhur me materialin sipas rregullit 103 dh
12 etani dua t'i jap fjalën z. Roberts.

13 Fjala për ju, z. Roberts.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

15 Unë fatmirësisht, jam plotësisht dakord me atë çfarë u
16 tha nga kolegët e mi z. Kehoe dhe z. Emmerson. Ne mendojmë që
17 qasje e vetme logjike dhe sensitive është që neve të na jepet
18 secili prej dokumenteve të dhëna në listë.

19 Kam dy gjëra shumë të shkurtra që dua të nxjerrë lidhur
20 me këtë.

21 E kam fjalën këtu për nxjerrjen e 1.386 dokumenteve që
22 janë në lista. Ky është kuptimi im - por do të doja që të më
23 korrigjonte ZPS-ja në qoftë se unë e kam gabim - por janë të
24 gjithë dokumentet provuese që ne kemi kërkuar. Dhe ndërkohë
11 tabela e rregullit 109 mund të bëhet në kohën e njëjtë me
12 dosjen sepse kjo ë e bëshme.

13 Për sa i përket listës së dëshmitarëve që na është dhënë
14 dhe këtë e diskutuam hollë e gjatë më herët. Ata në atë listë
15 përmendin 327 dëshmitarë. Në atë listë kanë 266 dëshmitarë që
16 do të dëshmojnë drejtpërsëdrejti në sallën e gjyqit, 266.

17 Dhe ta shtoj edhe kemi 20 të vdekur në atë listë dhe
18 njëri prej tyre është i listuar se do të japë dëshmi të
19 drejtpërdrejtë. Nuk e di sesi mund të ndodhë që një i vdekur
20 të vijë të japë dëshmi këtu por sidoqoftë në atë listë kemi
21 dhe 20 persona që tashmë nuk janë gjallë.

22 Dhe afati kohor për këto dëshmi? Ne tani nuk e kemi as
23 materialin sipas rregullit 102(1)(b) për tetë dëshmitarë.
24 Mendoj që ishin tetë dëshmitarë. Nuk dimë asgjë për këto
25 persona. Tani a kanë probleme me listën e dëshmitarëve të ZPS-

1 së parashtohet pyetja? Po ka shumë probleme me këtë listë:

2 Redaktimet, nxjerrja e atyre, numri i dëshmitarëve.

3 Këta dëshmitarët, numri i madh i tyre, që do të dëshmojnë
4 në mënyrë të drejtpërdrejtë të cilët nuk janë identifikuar.
5 Domethënë bëhet fjalë për 37 për qind dëshmitarësh, 37 për
6 qind të dëshmitarëve të propozuar të Prokurorisë tani po
7 prezantohen në këtë pikë kohore pa asnjë informacion
8 identifikues. Emri i tyre është i redaktuar, koha është e
9 redaktuar, periudhat kohore në përgjithësi janë të redaktuara,
10 ngjarjet janë të redaktuar, kush ka qenë aty është redaktuar
11 dhe kështu me radhë. Atëherë në bazë të çfarë mund të punojmë
12 ne?

13 Unë thjesht them se kjo është një aspekt për të cilën
14 Gjykata duhet të parashtrojë pyetje si ne mund të bëjmë një
15 njoftim për alibi kur nuk e dimë se çfarë ka ndodhur dhe cila
16 është çështja e Prokurorisë.

17 Për shembull klienti im për pjesën e ngjarjeve që kanë
18 ndodhur në vitin 1998 ka qenë jashtë vendit. Si mund të japë
19 një mbrojtje në bazë të alibisë pa e pasur informacionin që
20 duhet të ma japë Prokuroria. Edhe pse mirëpresim informacionin
21 që po na dorëzohet, ne kemi nevojë për një informacion më të
22 plotë. Vetëm me 37 për qind informacion nuk mund të
23 përgatitemi.

24 Është një problem serioz. Dhe gjithë mënyra sesi e ka
25 strukturuar këtë çështje Prokuroria është një problem serioz:

1 mungesa e informacionit, redaktimet e kështu me radhë. Ata
2 p.sh., më kanë dhënë një deklaratë forenzike në lidhje me dikë
3 ku është redaktuar emri i personi që ka vdekur para 20
4 vjetësh. Domethënë ky person ka vdekur para 20 vjetësh dhe
5 emri i tij është redaktuar. Nuk e di për çfarë arsyesh për
6 qëllime të sigurisë. Nuk kam asnjë farë ideje sesi kjo mund të
7 jetë e logjikshme.

8 Në bazë të analizës që bëj unë duhet t'i vihet kufiri
9 këtyre redaktimeve dhe marrja e informacionit për 122
10 dëshmitarë nga kjo listë 30 ditë përpara fillimit të gjykimit
11 është thjesht e pamundshme. E di që po i përsëris komentet që
12 janë bërë eshë nga palët e tjera, mirëpo me siguri e keni të
13 qartë se nga pikëpamja jonë si Mbrojtje kur e merr një listë
14 dëshmitarësh të tillë, thjesht nuk kam problem me ata që kanë
15 vdekur, por njerëz që do të vijnë këtu që do të paraqesin
16 dëshminë e tyre dhe për të cilët ne nuk kemi kurrfarë
17 informacioni dhe nuk mund të bëjmë kurrfarë intervistash me të
18 për këtë, me të vërtetë nuk di se çfarë të them. Kjo thjesht
19 na i limiton mundësitë si Mbrojtje.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Urdhëroni z. Emerson.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirëpres komentet e z. Quick për
23 herë të parë që në sallë bëri parashtrime gojore.

24 Asnjëherë, nuk mund të thuash se mungesa e burimeve është
25 justifikim i ligjshëm i mbajtjes së dikujt në parandalim.

1 Është një parim themelor i të drejtës ndërkombëtare që njihet
2 nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ekziston
3 një lidhje e drejtpërdrejtë midis keqmenaxhimit të dukshëm.

4 Çdo prokuror profesionist duhet ta kishte planifikuar
5 gjithë këtë përpara fillimit të procesit. Sigurisht që nuk do
6 të kishte çorientuar Gjykatësin apo palët në lidhje me afatet
7 kohore dhe nuk do të kishte ardhur para jush të thotë "o kemi
8 shumë punë".

9 Kjo asnjëherë nuk mund të shërbejë si një justifikim
10 "kemi shumë punë dhe duhet ta shtyjme tani edhe gjykimin". Ju
11 i nderuar Gjykatës e dini se ky gjykim efektivisht nuk mund të
12 fillojë përpara 2023. U premtua se do të fillonte në qershor
13 të këtij viti.

14 Dhe gjithë kjo varet dhe është rezultat i Jack Smithit.
15 Ai është Prokurori. Znj. Lawson faktikisht -- paaftësia e saj
16 për ta njohur vetë situatën në të cilën gjendemi, mënyra e saj
17 jo profesionale dhe jo reale e refuzimit për të pranuar
18 situatën në të cilën ndodhet Prokuroria, e cila është e
19 dukshme për të gjithë të tjerët në këtë sallë, si të thuash
20 dritat janë ndezur po askush nuk duket brenda nuk është në
21 shtëpi. Dhe një është mbas timonit.

22 Dhe tani të kërkosh nga z. Quick të japë, të paraqesë të
23 njëjtat justifikime por në një zë tjetër nuk do ta ndihmojë
24 askënd. Në qoftë se kishin nevojë për burime, për kapacitete
25 ishte detyra e Prokurorisë që t'i siguronte ato burime përpara

1 se të arrestonte njerëz. Dhe jurisprudenca është e qartë në
2 nenin 6 se burimet nuk mund asnjëherë të përdoren si
3 justifikim për një vonesë të paarsyeshme. Ne tani
4 ballafaqohemi me nenin numër 6.

5 Ne nuk mund të vazhdojmë t'i mbajmë këta njerëz në
6 paraburgim dhe të mos ta dënojmë Prokurorinë e cila po bën
7 shkelje të nenit 6 të GJEDNJ-së. Për shkak të mungesës së
8 profesionalizmit të Prokurorisë dhe planifikimit të gabuar që
9 kanë bërë po ndodhin gjithë këto dëme.

10 Unë do të them që znj. Lawson nuk i pëlqen toni im,
11 mirëpo ky është një lëshim i madh i Prokurorisë për shkak të
12 gabimit të tyre. Ata duhen faktikisht të ngrihen në këmbë dhe
13 të thonë "na vjen keq, në fakt ne kemi thënë se do të fillonim
14 në qershor, e kemi akuzuar Mbrojtjen se po na çorienton me sa
15 që mundet. Ne e kemi interpretuar keq situatën në të cilën
16 ndodhemi. Kemi pasur shumë probleme me burimet dhe kështu me
17 radhë". Është një keqmenaxhim i gjithë çështjes.

18 Kemi të bëjmë me pamundësinë e Prokurorisë që të
19 konfrontohet me realitetin. I gjithë ky argumentim është një
20 turp. Ndoshta është hiperbolë kjo që sapo thashë për
21 prokurorët, për ata të cilët flasin në qasjen e personave të
22 cilën nuk janë emotivë, emocionalë fare. Megjithatë të gjithë
23 e dinë të gjithë të akuzuarit dhe jo vetëm komuniteti i të
24 drejtës penale, por gjithashtu edhe njeriu i zakonshëm në
25 rrugë në Kosovë e di se cili është pozicioni i tyre.

1 Ju jeni një prej gjykatave të tyre. Ju duhet të dini që
2 të gjithë po ju shohin.

3 Seriozisht. Tani kemi një person të ri, një fytyrë të re
4 që thotë "a vjen shumë keq, por kemi pasur shumë punë, kemi
5 qenë shumë të ngarkuar. Kemi kaq shumë përgjigje për të
6 dhënë". Pra, planifikimi -- kjo është çështje e tyre. Kjo
7 është çështja e madhe. Kështu e quajnë ata në ZPS. Domethënë
8 kjo është çështja e madhe për ta.

9 Është çështja e madhe jo se e ka prova kundër të
10 akuzuarve, por është punë e madhe për shkak të katër peshqve
11 të mëdhenj që duan të zënë ata. Dhe siç e thashë më përpara,
12 ata janë arrestuar pa asnjë lloj ideje dhe akoma nuk e kanë
13 idenë fare se pse i kanë marrë këta njerëz.

14 Por pse nuk mund ta kishim për shembull dosjen
15 paragjyqësore deri më 31 tetor? Pse kërkohet shtyrja deri me
16 datë 17 dhjetor, përpara se të merret pushimi për
17 krishtlindje? Pra pa marrë asnjë hollësi nga Prokuroria ne
18 duhet ta pranojmë. Dhe ajo çfarë po ndodh është që ata po
19 mundohen që të shtyjnë 109-n, materialet që bien nën rregullin
20 109 deri në janar.

21 Pra, kjo është situata që - ju kërkohet ndjesë për termin -
22 por do të marrim një proces ose një dosje paragjyqësore që do
23 të jetë gjysmë-dosje. Pra nuk do të kemi absolutisht asnjë gjë
24 specifike deri më datë 28 janar.

25 Dhe prapë në qoftë se Prokuroria e di, e njeh çështjen e

1 vet, pra mund ta kenë dosjen paragjyqësore. Në qoftë se ata
2 nuk e dinë se cila është çështja e tyre, çfarë dreqin po bëjmë
3 këtu? Ju nuk i jeni përgjigjur kërkesës as me gojë as me
4 shkrim lidhur me rregullin e datës 31 tetor. Ndërkohë që
5 Mbrojtja e z. Selimi ka dhënë një parashtrim shumë të
6 arsyetuar se pse urdhri duhet të jetë më 26 nëntor dhe në këtë
7 mënyrë, pra është e rëndësishme që në konferencën e dhjetorit
8 ne të dimë se cila dhe të jetë çështja e Prokurorisë.

9 Ndoshta ju do të shikoni që ata nuk është se kanë një
10 çështje. Dhe këtë duhet që ta merrni parasysh në vendimin që
11 do të merrni për rishikimin e mbajtjes në paraburgim të katër
12 burrave dhe për të vendosur në qoftë se do të qëndrojnë apo jo
13 në paraburgim ende ata gjatë Krishtlindjeve.

14 Kështu që, situata është bërë shumë më e komplikuar. Ka
15 dalë komplet nga kontrolli. Ju keni domethënë -- po të ishte
16 ndryshe, po të kishim një Panel Gjyqësor do të kishit kolegë
17 që të konsultoheshit, ndërkohë që aktualisht e gjithë barra
18 është në shpatullat tuaja.

19 Sa i takon listës së dëshmitareve, kam një gjë për të
20 thënë dhe kjo lidhet me atë çfarë ngrita pak më parë lidhur me
21 dallimin ndërmjet një Dhome të Procesit Paragjyqësor dhe
22 Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe fakti që përgjegjësia
23 është e ndryshme, pavarësisht që formulimi është i ndryshëm --
24 përgjegjësia është e njëjtë megjithëse formacioni është i
25 ndryshëm. Pra, është përgjegjësia jua që këtë çështje t'ia

1 dorëzoni Trupit Gjykses në një format, në një formë që është e
2 gjykseshme.

3 Do t'ju jap ca statistika dhe shpresojmë që kësaj here të
4 mos e kemi përgjigjen që "ne jemi shumë më efikasë sesa
5 Gjykatat e tjera" se këtë kemi dëgjuar që në fillim fare. Që
6 në fillim fare kemi dëgjuar që "ne jemi shumë më të shpejtë se
7 gjykatat e tjera. Jemi krijuar në mënyrë të tillë që të jemi
8 super efikasë". Pra z. Smith nuk është asnjëherë në Gjykatë
9 për të mbrojtur mungesën e tërë të menaxhimit të zyrës së tij.

10 Megjithatë t'i jap edhe një herë statistikat. Tani më
11 lejoni të jap disa statistika sa i takon dëshmitarëve dhe
12 gjatësisë së procesit gjyqësor.

13 Mbështetur në përvojë, në çështjen e Popoviçit që e
14 kishte ekzaktësisht të njëjtën numër të dëshmitarëve nga ana e
15 Prokurorisë 328, ka marrë tre vite, nëntë muaj dhe 20 ditë për
16 t'u gjykuar. Gjyqi kundër Milutinoviçit, që kishte 242
17 dëshmitarë ka marrë dy vite, shtatë muaj dhe dhjetë ditë.
18 Ndërkohë që çështja kundër Prliçit me 320 dëshmitarë, ka
19 zgjatur për shtatë vite dhe një muaj.

20 Pra në mënyrë të përgjegjshme, ju nuk mund t'ia dorëzoni
21 një çështje të këtij dimensionit Trupit Gjykses edhe të
22 shkarkoheni tërësisht nga funksionet tuaja. Për këtë arsye, ju
23 kërkohet tani, të bëni një urdhër, mund t'i vini çfarëdolloj
24 date të doni ju, por të bëni një urdhër, të merrni një urdhër
25 që Prokuroria të justifikojë rëndësinë e secilit dëshmitar

1 përpara sesa ata të përshihen në çështjen që do t'i jepet
2 Trupit Gjykues.

3 Pra, përmes letrave, dokumenteve thuhet domethënë që do
4 të kishim mundësi që ta bënim këtë deri më 28 janar, pastaj do
5 thonë "do vijmë prapë", [se] duan që afati kohor të shtyhet
6 deri në fund të marsit. Dhe jam i sigurt që ju do të shokoheni
7 sepse unë personalisht jam i shokuar me atë se çfarë kanë
8 ofruar ata. Domethënë ofrimi i vlerës provuese të dokumentit
9 që kanë dhënë nuk është asgjë.

10 Pra me këtë rast dua të them që Prokuroria është e
11 pamenaxhuar dhe ju jeni personi i vetëm që mund t'i vendoni
12 pak nën kontroll zyrën e Prokuroria. Kështu që edhe një herë
13 dua t'ju kërkoj, t'i detyroni ata, ta detyroni Prokuroria që
14 të shpjegojë dhe të justifikojë se cili prej dëshmitarë, se në
15 të kundërtën do të jemi në një situatë, do të kemi një proces
16 gjyqësor që do të zgjasë për 4 vjet.

17 Më lejoni të them që zotërinjtë kanë muaj të tërë që janë
18 në burg, ndërkohë që ZPS-ja një pjesë të vogël të dokumenteve
19 të tyre kanë zbuluar. Nuk janë ende gati për të ofruar dosjen
20 e procedues paraprake dhe dosjen paragjyqësore dhe pavarësisht
21 kësaj edhe informacionin e rëndësishëm për ne në këtë moment
22 duan ta shtyjnë nga fundi i janarit.

23 Kështu që nuk të duhet të jesh shumë i zgjuar nuk të
24 duhet të jesh mjek që të diagnostikosh që pacienti vuan nga
25 një sëmundje shumë e rëndë. Pra, më vjen keq por është momenti

1 që juve t'i detyroni ata se nuk ka asnjë mënyrë tjetër, nuk ka
2 asnjë mënyrë tjetër që ju të lejoni procesin gjyqësor të
3 vijojë më tej dhe unë në fakt ju përmenda rastin e një
4 dëshmitari i cili nuk ka fare rëndësi për procesin gjyqësor në
5 fjalë.

6 Mënyra sesi funksionon në tribunalet penale --

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, ju kërkoj
8 ndjesë, është ora 18.30 [sipas përkthimit].

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] 18.30 është edhe për mua, por
10 është një Konferencë për Ecurinë e Çështjes.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më duhet ta mbyll seancën
12 në orën 18.30. Kështu që do të doja që t'i kërkoja kolegëve që
13 të shprehen, sepse në të kundërtën ata do të mbeten pa u
14 shprehur.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të ulem, por ideja është që
16 kjo është një kërkesë formale për juve që të shqyrtoni datën e
17 përshtatshme dhe t'i jepni një urdhër ashtu siç kërkohet nga
18 Mbrojtja e z. Selimi që të ofrojnë dosjen paragjyqësore në
19 kohën e diskutuar, pra më 26 nëntor në mënyrë që të kemi dy
20 javë në dispozicion përpara sesa të vijmë sërish në
21 Konferencën e radhës për Ecurinë e Çështjes. Dëshirojmë po
22 ashtu që të nxirrni një tjetër urdhër rreth datës 28 janar ku
23 duhet të justifikohet, sepse secili prej dëshmitarëve të
24 Prokurorisë duhet që të thërritet në procesin gjyqësor. Sepse
25 pjesa më e madhe e trupave gjyqësore mund të arrijnë në

1 përfundimin që kjo shifër do të duhej që të shkurtohej me dy
2 të tretat.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

4 Z. Roberts.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kam ndonjë
6 gjë të madhe për të shtuar. Parashtrimet e mia i kam bërë me
7 shkrim. Mendoj që janë të arsyeshme. Mendoj që ekzistojnë
8 arsye të qenësishme të cilat do të dua që të shtjellohen më
9 tej edhe që u shtjelluan në fakt më tej nga kolegët e mi se
10 pse na duhen në fakt këto informacione përpara konferencës
11 tjetër sepse do të vijë janari dhe nuk do kemi bërë asgjë,
12 veçse sa do kemi shtyrë afatet më tej. Jam plotësisht dakord
13 me shqetësimet e kolegëve përderisa të gjithë të akuzuarit
14 janë njësoj të ndaluar.

15 Një tjetër gjë që dua të diskutoj është nxjerrja e
16 listës. Neve sugjeruam kategorizimin më përpara në mënyrë të
17 tillë që procesi të ndihmohet me Prokurorinë që duhet që të
18 kategorizojë provat e tyre në Legal Workflow. Prokuroria duhet
19 të kuptojë se me çfarë lidhet secila prej dokumenteve dhe në
20 qoftë se do të kishin lexuar të gjitha kërkesat tona mendoj që
21 Prokuroria do të kishte qenë në pozicion më të mirë për të
22 bërë gati dosjen paragjyqësore më përpara.

23 Nuk dua të them që ju kishim thënë që situata do të ishte
24 kjo, por kjo është situata në fakt.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

1 Z. Ellis.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Është parashtrimi i protokolluar
3 0097 [sipas përkthimit], paragrafi 14, ku ZPS-ja thotë:

4 "Kjo çështje duhet të fillojë këtë verë ose jo më vonë
5 sesa shtatori i 2021".

6 Ndërkohë sot kemi Prokurorinë që thotë që nuk janë në
7 gjendje që të dorëzojnë dosjen paragjyqësore përpara datës 17
8 dhjetor. Megjithatë, besoj që sa herë që pretendohet një gjë e
9 tillë duhet që t'i kthehemi këtij parashtrimi të protokolluar
10 që unë përmenda më sipër. Si ka mundësi që Prokuroria ka dhënë
11 këtë vlerësim për fillimin e gjykitimit ndërkohë që dokumentet
12 nuk janë akoma në dispozicion sot e kësaj dite.

13 Jemi dakord me ekipet e tjera të Mbrojtjes dhe do të
14 thonim që për çështjet praktike do të ishte mirë që të mos ta
15 linim datën e fundit përpara pushimit të dimrit. Sepse mund të
16 jemi në një situatë të tillë që të kërkohet shtyrja më tej.
17 Kështu që jemi plotësisht dakord me datën që sugjerohet nga
18 Mbrojtja e z. Selimi.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Ellis.

20 Zoti Prokuror, shkurtimisht ju lutem.

21 Z. QUICK: [Përkthim] Më lejoni të ngre dy çështje.

22 Sa i takon vlerësimeve të përfaqësit të cilat janë dhënë
23 më përpara ato janë dhen duke marrë parasysh rrethanat
24 ekzistuese në atë kohë dhe në dispozicion, që kemi pasur në
25 dispozicion atëherë. Është pjesë e pandashme e çështjeve të

1 tjera, që rrethanat të ndryshojnë, dhe në fakt ne kemi pasur
2 rrethana shumta që kanë çuar në ndryshimin e parashikimeve.

3 Ne po i tregojmë Gjykatës që po bëjmë progres në të
4 gjithat zërat e punës. Ndërkohë ka shumë proces pune të cilat
5 duhet të trajtohen, duhet të përfundojnë përpara sesa çështja
6 të jetë gati për gjykim dhe përpara sesa të dorëzohet dosja
7 paragjyqësore. Ndërkohë shumë prej këtyre proceseve janë
8 paralele me njëra-tjetrën.

9 Mbrojtja e Thaçit dhe e Veselit duket sikur nuk e
10 kuptojnë mirë natyrën e rregullës 109(c) dhe të dosjes
11 paragjyqësore. Dosja paragjyqësore do të ketë poshtëshënime
12 lidhur me provat e ZPS-së. Përveç këtyre provave dhe
13 kategorizimit në Workflow, ZPS-së i është kërkuar gjithashtu
14 që të japë edhe tabelën sipas rregullit 109(c).

15 Sa i takon rëndësisë së dëshmitarëve, qëllimi kryesor i
16 materialeve sipas rregullit 95(4) është pikërisht ky.
17 Përfshirë këtu edhe dosjen paragjyqësore dhe tabelat që
18 kërkohen sipas rregullit 109(c).

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Kehoe, shumë shkurt, ju lutem.

21 Z. Kehoe: [Përkthim]

22 ZPS-së nuk po i kërkohet të bëjë diçka. Por rregullat i
23 kërkojnë Prokurorisë që të bëjnë diçka. Nuk është se dikush po
24 i sugjeron diçka që të bëjë ZPS-së, por Rregullorja që ZPS-ja
25 duhet të bëjë procese të caktuar kohe. Dhe ata nuk po na e

1 shpjegojnë dot se pse nuk na i japin dot dokumentet, domethënë
2 momentin kur të japë dosjen paraprake.

3 Pjesa më e madhe e Aktakuzës ose e procesit gjyqësor janë
4 marrë me copy and paste në dokumente të tjera, në gjykata të
5 tjera, si për shembull në TPNJ. Shohim të njëjtat gjëra,
6 shohim të njëjtin dokument. Dyshoj që edhe dëshmitarët vetë do
7 të jenë të njëjtët.

8 Pra, nuk e di çfarë po bëjnë, po bëjnë rivlerësim, po
9 shpikin rrotën edhe një herë. Kështu që nuk e di se pse po
10 kërkon kaq shumë kohë dhe me gjithë respektin, i nderuar
11 Gjykatës, thjeshtë mbledhja e të gjitha argumenteve, paraqitja
12 e pozicionit të tyre, pra nuk ka qenë fare serioze.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju lutem zonja Prokurore.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të flas shumë shkurt sepse
15 pjesa më e madhe e çështjeve janë dhënë nga kolegu im.

16 Gjithsesi, dëgjuam komentet personalizuara, komentet
17 personale kundër meje ose anëtarëve të tjerë të ZPS-së që u
18 përmendën nga z. Emmerson, nuk është e shpejtojnë këtë proces.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk do ta pranoj këtë. Kjo është
20 për të ardhur turp.

21 Sa herë zonja Lawson çohet në këmbë, më kritikon mua dhe
22 nga ana ime ajo nuk pranon dot as kritikën më të vogël për
23 shkak të sjelljes së saj. Ajo përgjigjet me mungesë të tërë
24 dhembshurie dhe mungesë të tërë konsiderate për ndalimin e
25 këtyre personave.

1 Po ashtu edhe z. Black është komplet jashtë kontrollit.
2 Pra, të gjithë thonë në qoftë se e kemi lexuar transkriptin,
3 besoj se do ta kuptoni. Ne të gjithë po themi "që këto
4 vlerësime janë tërësisht jorealiste. Ne po themi që ju duhet
5 të ndërtoni kapacitet për atë çfarë do të ndodhë".

6 Ndërkohë që ajo që bëni ju është që jeni këtu dhe nuk
7 bëni gjë tjetër veçse i kërkon Gjykatësit që të shtyjë afatet
8 kohore. Në qoftë se nuk ju pëlqejnë kritikrat duhet të filloni
9 që të silleni në mënyrë profesionale.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Le të kalojmë në pikën
11 tjetër në agjendë. Hetimet sipas ekipeve të ndryshme.

12 Do të doja që të dëgjoja nga ekipet e Mbrojtjes, një herë
13 në qoftë se ato kanë bërë progres lidhur me hetimet.

14 Z. Kehoe, fjala për ju.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Sigurisht Gjykatës. Ne kemi të
16 gjitha dokumentet që fillojnë e na jepen përditë dhe ju thashë
17 në fakt 17 për qind e dokumenteve që kemi janë parashtruar për
18 neve që nga Konferenca e fundit për Ecurinë e çështjes dhe po
19 mundohemi të marrim me mend se çfarë do të thonë dëshmitarët.
20 Sepse nuk ka një mënyrë konsistente të caktimit të numrave për
21 dëshmitarët e për dokumentet. E ky është një proces që kërkon
22 kohë.

23 Atëherë, tani sa i takon hetimeve në terren pavarësisht
24 çështjeve të lidhura me Covidin, pavarësisht pozicionit të
25 këtyre akuzave nga ZPS-ja dhe pa parë dosjen paraprake, pra

1 nuk po them që nuk po hetojmë po për shkak të shpejtësisë,
2 efikasitetit, por edhe të çështjes së kostos financiare, ne na
3 duhet që të shohim që çfarë pretendohet nga ZPS-ja dhe nuk
4 kemi pasur mundësi që ta bëjmë këtë gjë.

5 Pra, nuk është se po i them kësaj Gjykate që nuk po bëjmë
6 asgjë se nuk është ky rasti, po besoj i nderuar i Gjykatës të
7 kuptoni se neve duhet të kemi në dorë, duhet ta kemi para syve
8 se cili është pretendimi i ZPS-së në mënyrë që neve të japim
9 një përgjigje të mirëqenë dhe nuk dua të përsëris atë çfarë
10 thashë në Konferencën e mëparshme.

11 Pra për momentin nuk kemi ndonjë përgjigje specifike për
12 pyetjen tuaj, megjithatë mund ta shqyrtojmë me kalimin e kohës
13 serish.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

15 Z. Emmerson.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne kemi krijuar një ekip hetues
17 me një zyrë në Kosovë në Prishtinë. Kemi një drejtues ekipi.
18 Megjithatë po presim se cila është çështja kundër klientit
19 tim. Pra këta janë persona të cilët janë në listë pagese por
20 nuk e dinë se çfarë do të hetojnë sepse nuk kanë marrë një
21 çështje domethënëse, një çështje të qartë nga Prokuroria.

22 Më lejoni ta bëj të qartë: si avokat mbrojtëse, unë jam
23 përgjegjës për ekipin tim dhe ju keni plotësisht të drejtë të
24 pyesni se çfarë po bën dhe si po vijon dhe si po bëni
25 përparime, progres. Por do të doja që të njëjtën përgjegjësi

1 ta merrte edhe ana tjetre e Gjykatës.

2 Dhe sa na takon ne, ne gjendemi në një situatë që po
3 bëjmë më të mirën e mundshme dhe pa pasur materialet të cilat
4 do të na duhet që t'i kërkojmë në një mënyrë tjetër, domethënë
5 janë 68.000 dokumentet. Pra në qoftë se nuk do ta bëjmë në
6 mënyrë gjenerike të përgjithshme, do t'i bëjmë gradualisht
7 njëra pas tjetrës sepse të gjitha këto dokumente janë
8 potencialisht të rëndësishme për këtë çështje të tmerrshme. Ne
9 kemi nevojë për të gjitha këto dokumente.

10 Pra, çështja është sa mund ta zgjasësh një copë llastik.
11 Pra për aq kohë sa ne nuk fillojmë dot që të hetojmë përpara
12 janarit apo mundësish deri në datë 28 janar dhe pavarësisht që
13 unë dyshoj që dosja paragjyqësore nuk do të mbajë informacione
14 që ne pretendojmë dhe që duhet të ketë, por mundohen që të
15 blejmë më shumë kohë sesa ç'kanë blerë deri tani, por sikur ta
16 zëmë që do fillojë nga mesi i janarit, nga fundi i janarit,
17 vlerësimi më i mirë që mund t'ju jap unë juve është që gjykimi
18 ndoshta të fillojë nga janari-shkurti 2022.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

20 Z. Roberts.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar, i
22 nderuar Gjykatës. Nuk kemi bërë shumë progres. Jemi thujse në
23 të njëjtat ujëra si me skuadrat e tjera të Mbrojtjes dhe jemi
24 të prekur nga mungesa e pretendimeve specifike kundër klientit
25 tim, ashtu siç është rasti edhe me ekipet e tjera të

1 Mbrojtjes.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

3 Z. Ellis.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Jemi në të njëjtin pozicion edhe
5 neve. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I konfirmoj palëve që
7 Konferenca a radhës për Ecurinë e Çështjes do të organizohet
8 më 15 dhjetor në orën 14.30 sipas orës së Hagës. Këtë e kam
9 dhënë edhe në Konferencën e mëparshme për Gjendjen Gjyqësore.

10 Në këtë pikë do të doja t'ju kërkoja palëve në qoftë se
11 ka ndonjë çështje tjetër që duan të ngrenë, përfshirë ose
12 ndoshta duke filluar me zyrën e Administrimit.

13 Nuk e di në qoftë se jeni në gjendje që të na jepni
14 detajet lidhur me përkthimet z. Roche?

15 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit. Sa i takon dokumentit
16 5548, versioni i parishikuar i këtij përkthimi do të jepet në
17 orën 16.00 të hënën. Faleminderit.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Nuk ka përkthim].

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, duhet të ta
20 jap unë fjalën.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Neve do të dorëzojmë përkthimin
22 jozyrtar që po përdorim. Por ndoshta do të duhej që ta
23 shqyrtoni atë që të punojmë paralelisht.

24 E di që normalisht duhet bërë me shkrim kjo, por duke
25 pasur parasysh gjërat sesi janë trajtuar çështjet nga ZPS-ja

1 dhe fakti që zonja Lawson nuk ka hequr parakushtet e caktuara
2 për dokumentin, do të na duhet ca kohë. Nuk e di do t'i kërkoj
3 zotit Strong për të më thënë numrin ekzakt të fjalëve që do të
4 duhet të përdoren për të bërë parashtrimet.

5 Z. STRONG: [Përkthim] Thuajse 1500 fjalë besoj që janë
6 të mjaftueshme.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, do të jap një
8 urdhër gojor dhe lejoj shtimin e 1500 fjalëve të tjera për t'u
9 kundërpërgjigjur.

10 Ky është fundi i urdhrin të parë gojor.

11 Zonja Prokurore, fjala për ju.

12 Z. LAWSON: [Përkthim] Sa për t'ju përgjigjur elementit
13 të fundit që është ngritur nga Mbrojtja e zotit Veseli.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Prokurore, ju thatë
15 që këtë do ta trajtoni me shkrim, kështu që për aq kohë sa do
16 të trajtohet me shkrim ndërmjet palëve ju lutem bëni këtë gjë.
17 Nuk do ta ngremë këtë çështje tani se është ora 18.28 [sipas
18 përkthimit].

19 A ka ndonjë çështje tjetër materiale që doni të ngrini
20 përveç kësaj? Nuk mund t'i kërkonit zotit Emerson të mos
21 ngrinjë gjëra të tilla në Konferencën për Ecurinë e Çështjes
22 dhe pastaj t'i ngrini vetë, kështu që ju lutem më thoni në
23 qoftë se keni ndonjë gjë tjetër për të thënë përveç kësaj.

24 Z. LAWSON: [Përkthim] Jo nuk kam gjë tjetër për të
25 thënë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kehoe.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Kemi çështjen e lirimit të
3 ndërmjetëm, të përkohshëm. Pra na ka kaluar -- afati ishte dje
4 ose pardje. Atëherë sa i takon [REDAKTUAR]
5 [REDAKTUAR]

6 kishte një mendim ndryshe nga njëri prej Gjykatësve dhe
7 Gjykatësi Ambos nuk ka qenë më në Panelin përkatës.

8 Në lidhje me ju, do t'ju kërkoja që të vijonit më tej me
9 disa prej pyetjeve, çështjeve që janë ngritur. Dhe ju lutem do
10 të doja t'ju kërkoja se çfarë rruge duhet të ndjekim neve sa i
11 takon kërkit të lirimit të përkohshëm. Pra, kemi një
12 përgjigje nga policia që është në proces përkthimi. Kemi një
13 proces të tillë, që ju e dini se deri në çfarë pike ka shkuar,
14 kështu që do të duam të kërkojmë mendimin tuaj se çfarë rruge
15 të ndjekim ne për të kërkuar për lirimin e përkohshëm të tyre
16 dhe duhet sikur ka kohë, do të duhet goxha kohë derisa sa të
17 fillojë procesi i gjykimit.

18 E kuptoj që ka shkuar vonë, por është një çështje shumë e
19 rëndësishme kështu që do të doja që të më jepnit udhëzime.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Udhëzime sa i takon afatit
21 kohor?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Çfarë është e mjaftueshme.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ne nuk po flasim për këtë
24 çështje. Nuk është pjesë e agjendës. Kështu që mund ta bëni me
25 shkrim kërkesën tuaj, mund ta përfshini këtë në parashtrimin

1 tuaj, por siç e thashë edhe për Prokurorinë kjo nuk është
2 çështje që është pjesë e rendit të ditës sot.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Është një çështje që është e
4 rëndësishme dhe duhej ta sillja në vëmendjen tuaj, në veçanti
5 për klientin tim, por jam i sigurt edhe për ekipet e tjera të
6 Mbrojtjes.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Kehoe.
8 Zoti Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Asgjë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Robertson.

11 Z. ROBERTSON: [Përkthim] Nuk kam asgjë as unë për të
12 thënë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] As unë nuk kam gjë për të thënë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Ellis.
16 Zoti Laws.

17 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Vetëm një
18 çështje që ka të bëjë me forumin e punës lidhur me Legal
19 Workflow dhe krijimin e subjekteve ligjore. Thjesht do të doja
20 të thoja për procesverbal që edhe ne duam që të përfshihemi në
21 këtë proces pune. Kaq kisha për të thënë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zoti Laws. E
23 mbajtëm shënim shqetësimin tuaj.

24 Përpara sesa të përfundojmë me këtë seancë, do jap disa
25 urdhra me gojë. Urdhrin e parë e dhashë, tani do të jap

1 urdhrin e dytë me gojë lidhur me dosjen paraprake të ZPS-së
2 dhe materialet e lidhura me të, sipas rregullës 95(4) (a) deri
3 në (c).

4 Në dritën e parashtrimeve të palëve dhe duke pasur
5 parasysh se po vijmë drejt përfundimit të nxjerrjes të
6 materialeve sipas rregullës 102(1) (b), urdhëroj ZPS-në të
7 parashtrojë materialet e saj të dosjes paraprake dhe të
8 lidhura me të sipas rregullës 95(4) (a) deri në (c) të
9 Rregullores, deri më 17 dhjetor 2021.

10 Gjithashtu urdhëroj ZPS-në të dorëzojë tabelën e saj
11 sipas rregullës 109(2) [sipas përkthimit] më 28 janar 2021
12 [sipas përkthimit].

13 Tani do të lëshoj urdhrin e tretë lidhur me afatin e ZPS-
14 së që lidhet me materiale të rregullës 102(1) (b).

15 Konstatoj në këtë drejtim se do të lëshoj një vendim për
16 kërkesën e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të ZPS-së për masa
17 mbrojtëse, pas afatit të 1 nëntorit për nxjerrjen e
18 materialeve sipas rregullës 102(1) (b).

19 Konstatoj më tej gjithashtu se ZPS-ja ka vënë në dukje se
20 materialet e rregullës 102(1) (b) pritet të dalin që janë: një
21 provë materiale e lidhur e një dëshmitari ndërkombëtar për të
22 cilën merret miratimi sipas rregullës 107 nuk u dha; versione
23 më të shkurtra apo të paredaktuara të transkripteve dhe prova
24 të lidhura me të, të tre dëshmitarëve; dhe deklaratat e
25 mëparshme dhe provat e lidhura me to për dy dëshmitarë që janë

1 subjekt i ndryshimit të kërkesave për masa mbrojtëse.

2 Duke pasur parasysh përpjekjet që po bën ZPS-ja për të
3 marrë miratim për këto materiale dhe përpjekjet e saj për të
4 përmirësuar efikasitetin e procesit të përkthimeve, konsideroj
5 se ka arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar të afatit
6 sipas rregullës 102(1) (b).

7 Afati ndryshohet dhe ZPS-ja urdhërohet t'i nxjerrë
8 materiale të tilla Mbrojtjes sa më shpjet që të jetë e mundur
9 dhe vazhdimisht, por jo më vonë se 31 janar 2021 [sipas
10 përkthimit].

11 Lidhur me përkthimin e materialeve sipas rregullës
12 102(1) (b) urdhëroj ZPS-në të japë përkthimet e mbetura sa më
13 shpejt që të jetë e mundur dhe në bazë të vazhdueshme por jo
14 më vonë se 31 janar 2021 [sipas përkthimit].

15 Këtu përfundon urdhri im i tretë.

16 Tani do të lëshoj urdhrin e katërt që ka të bëjë me
17 afatet në lidhje me materiale sipas rregullës 102(3).

18 Në dritën e parashtrimeve të palëve sot, unë e lë
19 pavendosur afatin në bazë të kërkesës për materialet e
20 rregullës 102(3).

21 Por pezullimi për afatet e ZPS-së në lidhje me materialet
22 e 102(3) mbetet.

23 Ndërkohë, palët duhet të vazhdojnë të nxjerrin materialet
24 sipas rregullës 102(3). Kjo përfshin materialet e kërkuara nga
25 Mbrojtja për përgatitjen e saj nga ZPS-ja dhe ZPS-ja duhet që

1 t'i përpunojë këto kërkesa.

2 Afati do të jepet në Konferencën tjetër për Ecurinë e
3 Çështjes, përveçse në qoftë se unë urdhëroj ndryshe.

4 Këtu përfundon urdhri im i katërt.

5 Dua t'i them palëve se do të vazhdojmë diskutimet për
6 këto materiale pas argumenteve të ngritura nga Mbrojta sot në
7 Konferencën tjetër.

8 Tani do të lëshoj urdhrin e pestë lidhur me kërkesën e z.
9 Selimi lidhur me materialet e [rregullit] 102(3).

10 Në parashtrimin e vet të 27 tetor 2021, Mbrojtja e z.
11 Selimi kërkoi që të gjitha dokumentet sipas rregullës 102(3)
12 të nxirren pa vlerësuar rëndësinë materiale të këtyre
13 dokumenteve.

14 Konstatoj se, rregulli 102(3) e Rregullores bën të
15 detyrueshme nxjerrjen kur tregohet, kur vihet në dukje
16 rëndësia materiale e tyre nga ana e Mbrojtjes. Kjo vjen për
17 shkak të natyrës së këtyre materialeve dhe bie ndesh me
18 natyrën detyruese të nxjerrjes në lidhje me materiale
19 mbështetëse të Aktakuzës, materiale që ZPS-ja synon t'i
20 përdorë në gjyq.

21 Dhe unë konstatoj se nxjerrja e të gjithë dokumenteve
22 sipas rregullës 102(3) duhet të ndjekë procesin e parashikuar
23 në Rregullore.

24 Kërkesa e Mbrojtjes së z. Selimi për këtë pikë, hidhet
25 poshtë.

1 Dhe këtu merr fund urdhri im i pestë.

2 Tani do të nxjerr urdhrin tim të katërt [sipas
3 përkthimit], për kërkesën e Mbrojtjes së z. Selimi lidhur me
4 kategorizimin e mëtejshëm, lidhjen dhe shqyrtimin e
5 materialeve të nxjerrjes.

6 Në parashtrimin e 27 tetorit, Mbrojtja e z. Selimi kërkoi
7 që përkthimet të rishikuara apo versionet më pak të redaktuara
8 apo dokumente me metadata të korrigjuara të lidhen në Workflow
9 me dokumentet origjinale që të gjitha dokumentet që lidhen me
10 z. Selimi të shikohen përsëri nga ZPS-ja dhe subjekte,
11 dëshmitarë të krijohen për të gjithë dëshmitarët në listën
12 paraprake të ZPS-së dhe të krijohet lidhja midis të gjitha
13 deklaratave dhe dokumenteve që lidhen me një dëshmitar të
14 caktuar.

15 Për të lehtësuar përpunimin nga Mbrojtja të materialit të
16 nxjerrë, urdhëroj ZPS-në që deri më 1 prill 2022 [sipas
17 përkthimit] të lidhë përkthimet, versionet e rishikuara apo më
18 pak të redaktuara apo versionet e korrigjuara të dokumenteve
19 me origjinalet në Legal Workflow.

20 Së fundi, i bëj thirrje Mbrojtjes së z. Selimi dhe të
21 gjithë të tjerëve, të angazhohen në diskutime midis palëve për
22 të shqyrtuar të gjitha dokumentet të kategorizuar se kanë
23 lidhje me z. Selimi dhe gjithashtu versionet më pak të
24 korrigjuara dhe ato -- të korrigjuara të lidhen me origjinalin
25 në Legal Workflow.

1 I ftoj palët që të më raportojnë për këtë çështje në
2 parashtrimet e tyre përpara konferencës tjetër për statusin.

3 Dhe këtu përfundon urdhri im i gjashtë.

4 Dhe informoj palët se kjo do të jetë një çështje që do të
5 diskutohet në Konferencën e ardhshme.

6 Këtu përfundon seanca sot. I falënderoj palët,
7 pjesëmarrësit për pjesëmarrjen.

8 Dëshiroj gjithashtu të falënderoj përkthyesit,
9 stenografin dhe teknikët sikurse dhe personelin e sigurisë.

10 Dhe dua ta informoj z. Kehow që do të urdhëroj redaktimin
11 e një fjalie që përmendët ju, pak përpara ndërhyrjes tuaj të
12 fundit sepse nuk ishte ende publike. Kishte lidhje me disa
13 vende të cilat ju i përmendët pak më herët.

14 Faleminderit shumë.

15 Kjo seancë përfundon këtu.

16 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes mbyllet
17 në orën 18.39

18

19

20

21

22

23

24

25